| 3.4 Aparatuara e përdorur..... | 51 |
| 3.5 Përgatitja e mostrave për analizë..... | 53 |
| 3.6 Procedura e punës dhe metodat e studimit | 55 |
| 3.6.1 Metodat referente për analizimin e mostrave reale..... | 56 |
| 4. REZULTATET DHE DISKUTIMET | 57 |

| | |
|--|------------|
| 4.1. Karakterizimi elektrokimik dhe performanca analitike e biosensorit elektrokimik bazuar në elektrodat e printuar për përcaktimin e paracetamolit | 57 |
| 4.1.1 Efekti i shpejtësisë së rrjedhjes në sistemin me analizë në rrjedhje | 61 |
| 4.1.2 Efekti i potencialit operues | 62 |
| 6.1.3 Efekti i vlerës pH | 64 |
| 6.1.4 Përformanca e sistemit..... | 65 |
| 6.1.5 Analiza e tabletave farmaceutike dhe urinës | 71 |
| 4.2. Karakterizimi elektrokimik dhe performanca analitike e biosensorit elektrokimik bazuar në elektrodat e pastë karboni për përcaktimin e polifenoleve..... | 74 |
| 4.2.1 Konstruktimi i biosensorit | 74 |
| 4.2.3 Karakteristikat e biosensorit | 75 |
| 6.2.4 Aktiviteti i tirozinazës kundrejt Troloksit..... | 76 |
| 4.2.4 Efekti i shpejtësisë së përzierjes dhe vlerës pH..... | 77 |
| 4.2.5 Efekti i potencialit operues | 77 |
| 4.2.6 Analiza e frutave..... | 78 |
| 4.3 Përcaktimi i kapacitetit total antioksidues ekuivalent me troloksin në mostrat e çokolletës duke përdorur elektrodën e diamantit dopuar me bor në sistemin me analizë në rrjedhje | 84 |
| 4.3.1. Voltametria ciklike | 84 |
| 4.3.2 Optimizimi i kushteve në analizën me injektim në rrjedhje | 84 |
| 4.3.3 Validimi i metodës | 88 |
| 4.3.4 Analiza e mostrave të çokolletës | 90 |
| 5. PËRFUNDIMET | 92 |
| 6. BIBLIOGRAFIA | 94 |
| 7. BIOGRAFIA | 103 |
| 8. ANEKS – KONFERENCA, PUBLIKIME DHE MOBILITETE SHKENCORE..... | 104 |
| 8.1__ Publikime shkencore | 104 |
| 8.2__ Konferencat Shkencore | 104 |
| 8.3__ Mobilitete shkencore | 109 |

Lista e tabelave

Tabela 2.1: Principet e shndërrimit dhe teknikat e matjes të sensorëve elektrokimikë

Tabela 4.1. Sjellja elektrokimike e paracetamolit në shëndërrues të ndryshëm amperometrik

Tabela 4.2. Prezantimi dhe krahasimi i disa biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit.

Tabela 4.3. Stabilizimi i sinjalit tek biosensori i ri.

Tabela 4.4 Krahasimi i rezultateve të FIA-s me ato të HPLC për mostrat farmaceutike dhe atë të urinës

Tabela 4.5 Përmbajtja e TEAC dhe AA në fruta të ndryshme

Tabela 4.6. Shqyrtimi i vlerave të TEAC në pulp të frutave përcaktuar nga analizat tjera TEAC (mg për 100 g)

Lista e figurave

Figura 1.1. Struktura e fenolit

Figura 1.2. Shembuj të komponimeve fenolike

Figura 1.3. Struktura kimike e molekulës së paracetamolit

Figura. 1.4. Mekanizmi i propozuar i oksidimit të paracetamolit në formë elektrokimike

Figura 1.5. Struktura e disa polifenoleve të cilat gjenden në bimën të ndryshme

Figura 1.6. Mekanizmi i propozuar i reduktimit të hidrokinonit nga acidi askorbik

Figura 1.7. Forma strukturore e tirozinazës (majtë) dhe pjesa aktive e saj (djathtë)

Figura 1.8. Mekanizmi i oksidimit të hidrokinonit nga tirozinaza

Figure 2.1. Procedimi i sinjalit nga organizmat e gjallë dhe procedimi nga një makinë inteligjente[

Figura 2.2 Paraqitja skematike e një sensori tipik kimik.

Figura 2.3. Parimi i punës së një biosensori elektrokimik

Figura 2.4. Celula elektrokimike me sistemin tri elektroda.

Figura 2.5. Sinjali i ekscitimit potencial-kohë gjatë eksperimentit në voltometri ciklike

Figura 2.6. Karakteristikat e një voltamogrami ciklik

Figura 2.7. Skema e përgjithshme dhe pajisjet e sistemit të analizës me injektim nën rrjedhje për detektim amperometrik

Figura 2.9 Disk elektroda e punës

Figura 2.10. Procesi i përgatitjes së pastës së karbonit dhe vendosja e saj në piston

Figura 2.11. Elektrodat të ndryshme nga karboni: A) Elektroda e printuar në shtresë të hollë, B) Elektroda nga karboni qelqor, C) Elektroda e diamantit e dopuar me bor

Figura 2.12. Disa materiale dhe nanomateriale nga karboni

Figura 3.1 A) Pasta e karbonit e përgatitur dhe B) Procesi i vendosjes së pastës në piston

Figura 3.2 Elektroda e komerciale e printuar e llojit DS-150

Figura 3.3 Elektroda nga karboni qelqor (A), dhe elektroda e diamantit e dopuar me bor (B)

Figura 3.4 Procesi i modifikimit të elektrodës së punës të tipit DS-150

Figura 3.5. Pamja e elektrodave të punës gjatë procesit të modifikimit. A) elektroda e printuar, B) elektroda pastë karboni

Figura 3.6 . Potenciostati/galvanostatin AUTOLAB medel PGSTAT 101

Figura 3.7 . (A) Celula elektrokimike nga DropSens, dhe (B) celula elektrokimike Inventek Sp. z o.o

Figura 3.8 Mikroskopin me skanim elektronik (SEM) JEOL JSM7500F

Figura 3.9. Ekstrakte e frutave pas procesit të filtrimit

Figura 3.10. Procesi i filtrimit për tretësirën e çokollatës

Figura 4.1 Voltamogrami ciklik i APAP me përqendrim $0.5\text{mmol}\cdot\text{L}^{-1}$ të elektroda e pamodifikuar SPCE(vija plotë), SPCE/MWCNT (vija e ndërprerë), dhe SPCE/NFG(vija me pika) realizuar në pufferin fosfat $0.1\text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$ pH 7.0, shpejtësi të skanimit $10\text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$

Figura 4.2. Voltamogrami ciklik i APAP me përqendrim $0.5\text{mmol}\cdot\text{L}^{-1}$ të elektroda e modifikuar me grafen (vija e ndërprerë), dhe elektroda e modifikuar me grafen dhe tirozinazë(vija me pika) realizuar në pufferin fosfat $0.1\text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$ pH 7.0, shpejtësi të skanimit $10\text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$

Figura 4.3 Efekti katalitik dhe oksidimi i paracetamolit nga tirozinaza.

Figura 4.4. Efekti i shpejtësisë së rrjedhjes

Figura 4.5 Efekti i potencialit operues. Elektroliti mbështetës pufferi fosfat 0.1, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100\text{ }\mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

Figura 4.6 Amperogramet e fituara në systemin FIA gjatë pesë injektiveve të tretësirës së holluar të urines(zi) dhe tretësirës cila përmban $50\text{ }\mu\text{ mol L}^{-1}$ APAP (kuq), në potencialle të ndryshme të punës. Elektroliti mbështetës pufferi fosfat 0.1, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100\text{ }\mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

Figura 4.7 Sinjali amperometrik për urinën e pastër (kaltër) dhe urinën me $50\text{ }\mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ paracetamol (verdhë). Elektroliti mbështetës pufferi fosfat 0.1M, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100\text{ }\mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

Figura 4.8 Sinjali amperometrik gjatë shtimit të paracetamolit në përqendrime të ndryshme, në potencial operues 0 V. Elektroliti mbështetës pufferi fosfat 0.1, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100\text{ }\mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

Figura 4.9 Sinjali amperometrik gjatë shtimit të paracetamolit në përqendrime të ndryshme, në potencial operues -0.15 V. Elektroliti mbështetës pufferi fosfat $0.1\text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100\text{ }\mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

Figura 4.10. Procesi i stabilizimit të elektrodës gjatë largimit të enzimës së pa inkorporuar.

Figura 4.11 Amperogram i fituar në sistemin FIA si rezultat i injektimit të tretësirës së paracetamolit me përqendrime të ndryshme në potencial -0.15 V. Elektroliti mbështetës pufferi fosfat $0.1\text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100\text{ }\mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C

Figura 4.12 Jetëgjatësia e biosensorit

Figura 4.13. Kromatogrami i fituar gjatë analizës së mostrës së urinës së pastër me HPLC(vija e plotë) dhe urinës që përmban $50\text{ }\mu\text{mol L}^{-1}$ paracetamol (vija e ndërprerë). Është përdorur kolona Ascentis Express C18 (150 mm x 3.0 mm, $2.7\text{ }\mu\text{m}$). Gjatësia valore e detektimit ka qenë 243 nm. Ndarja është realizuar duke përdorur fazën mobile e përbërë nga 0.3% acid formik në ujë (A) dhe metanol (B) me program të gradientit nga 20% deri në 40% B për 10 min në temperaturë konstante 30°C . Shpejtësia e rrjedhjes ka qenë 0.5 mL min^{-1} , vëllimi i injektimit $5\text{ }\mu\text{L}$.

Figura 4.14 Fotografitë e fituara nga SEM për elektrodën e pastër (A) dhe elektrodën e modifikuar me nanotuba të karbonit (B)

Figura 4.15 Efekti i sasisë së natotubave të karbonit të disperguara në DMF në piket e rrymave anodike (E_p^a) dhe atyre katodike (E_p^c) në përqendrimin e Troloksit $5\times 10^{-4}\text{ mol L}^{-1}$ tek elektroda pastër karboni, elektroliti mbështetës pufferi fosfat 0.1 mol L^{-1} (pH 7.0), shpejtësia e skanimit 0.05 V s^{-1} .

Figura 4.16 Voltamogramet ciklike ($n = 10$) të përsërituara në përqendrimet e Troloksit $500\text{ }\mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ të fituara në elektrodën e pastër (A) dhe voltamogramet ciklike për Troloksin me përqendrim 500

$\mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ në elektrodën e pa modifikuar CPE (vija e zezë), CPE/MWCNTs (vija e kaltërt) dhe CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® (vija e kuqe) (B), në puferin fosfat $0.1 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH = 7.0, $E_{\text{filllestare}} = 0 \text{ V}$, $E_{\text{vertex1}} = -0.5 \text{ V}$, $E_{\text{vertex2}} = +1.3 \text{ V}$, $E_{\text{step}} = 5 \text{ mV}$, $v = 10 \text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$.

Figura 4.17 Spektri ultraviolet i tirozinazës me përqendrim $50 \mu\text{g}\cdot\text{mL}^{-1}$ (lakorja e zezë) dhe $100 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ duke përdorur puferin fosfat $0.1 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH = 7.0 për 0 (lakorja e kuqe), 10 (lakorja kaltër), 20 (lakorja e gjelbër), dhe 30 min (lakorja e verdh).

Figura 4.18 Efekti i potencialit operues kur është përdorur CPE/MWCNTs (a), dhe CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® (b). Analiti $500 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ Troloks; elektroliti mbështetës puferi fosfat $0.01 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH 7.0; shpejtësi e përzierjes 400 rpm.

Figura 4.19 Analiza e TEAC duke përdorur metodën e shtimit të standardit me anë të biosensorit CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® në potencialin operues -0.25 V , shpejtësi e përzierjes 400 rpm.

Figura 4.20 Amperogram tipik i fituar duke përdorur biosensorin elektrokimik CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® gjatë shtimit individual të Troloksit me përqendrim $150 \mu\text{mol L}^{-1}$. Elektroliti mbështetës puferi fosfat $0.01 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH 7.0; shpejtësi e përzierjes 400 rpm.

Figura 4.21. Krahasimi i biosensorit elektrokimik me metodat tjera analitike (A) DPPH, (B) ORAC, (C) FRAP, (D) TRAP për analizën e TEAC në pulp të dredhëzës (Dre), manaferrave (Man), mjedrës (Mjed), boronicës (Bor) dhe boronicës së kuqe (Bkuqe).

Figura 4.22. Voltamogramet ciklike të përsëritura (5 cikle) 1 mmol L^{-1} të: Troloks (A), vanilinë (B), dhe theobrominë (C) regjistruar tek BDDE në 0.1 mol L^{-1} PB (pH 7.0), shpejtësi të skanimit prej 50 mV s^{-1} . Lakoret e zeza (blank) tregojnë që matja është bërë në pufer të pastër.

Figura 4.23. Ndjeshmëria në raport me shpejtësinë e rrjedhjes (A) dhe ndryshmi në intensitetin e rrymës kur është përdorur shpejtësia e rrjedhjes $0.2 \text{ mL}/\text{min}$ (B₁) dhe $1 \text{ mL}/\text{min}$ (B₂), potenciali operues $+1.3 \text{ V}$, gjatë shtimit të troloksit me përqendrim 50 ppm, bartës puferi fosfat pH = 7.0.

Figura 4.24. Varësia e intensitetit të rrymës ndaj ndryshimit të potencialit operues, BDDE si elektrodë e punës, pufer fosfat (pH 7.0), shpejtësi e rrjedhjes $1 \text{ mL}/\text{min}$, duke përdorur trolaksin me përqendrim 50ppm(A) dhe mostrën e çokollatës(B), lakorja me ngjyrë të kuqe paraqet rrymën bazike.

Figura 4.25. Efekti i metanolit në tretësirat e punës duke përdorur ekstrakt të çokollatës me 80% (ë/ë) kakao. Matjet janë realizuar duke përdorur BDDE në sistemin me analizë në rrjedhje, shpejtësi të rrjedhjes $1 \text{ mL}/\text{min}$ dhe potencial operues $+ 1.3 \text{ V}$. Ngjyra e kaltër e zbehtë tregon rrymën bazë.

Figura 4.26. Amperogram tipik i analizës me injektim në rrjedhje realizuar në BDDE, potenciali operues $+1.3 \text{ V}$, shpejtësia e rrjedhjes $1 \text{ mL}/\text{min}$, pufer fosfat me 30% MeOH (v/v).

Figura 4.27. Amperogrami hidrodinamik në FIA, gjatë matjeve të standardevë të Troloksit dhe mostrave të çokollatave me sasi të ndryshme të kakaos.

Figura 4.28 TEAC i çokollatës së bardhë (0%), me qumësht (30%), dhe asaj të zezë (50-80% kakao; w/w), regjistruar në FIA duke përdoruar BDDE.

REZYME

Komponimet fenolike në përgjithësi janë klasë e gjerë e komponimeve organike me rëndësi mjaftë të madhe. Ato janë molekula organike të cilat në unazën apo unazat aromatike përmbajnë një ose më shumë grupe hidroksile.

Komponimet me përbërje fenolike janë të përhapura shumë në botën e gjallë po ashtu edhe disa prej tyre sintetizohen nga industritë e ndryshme për nevoja të caktuara. Një pjesë e madhe e komponimeve më përmbajtje fenolike marrin pjesë në shumë procese metabolike në trupin tonë. Ato mund të metabolizohen ose të merren në formë të tabletave farmaceutike.

Acetaminofeni, i njohur si paracetamol, është një aminofenoli derivat (N-acetil-p-aminofenoli) me efekte analgjetike dhe antipiretike. Paracetamoli përdoret gjerësisht si zëvendësues i acidit acetilsalicilik dhe fenacetinës.

Përdorimi në doza të mëdha është treguar të jetë shumë i dëmshëm për shëndetin. Pjesa më e madhe e substancës aktive ekstrahohet nga trupi në formë të metaboliteve jo toksike në urinë (40-60% si glukuronat, 30% si sulfate), dhe 2% në formë të pandryshuar. Këto paraqesin fakte të rëndësishme për përcaktimin e paracetamolit në analiza klinike.

Polifenolet janë klasë e madhe e komponimeve kimike të cilat gjenden në shumë bimë, këto komponime kanë tërhequr vëmendjen për shkak të mirave shëndetësore që i posedojnë. Janë të njohura më shumë se 8000 komponime të cilat janë izoluar dhe përshkruar. Polifenolet mund të ndahen në tri grupe kryesore, flavonoidet, acidet fenolike dhe sibenoidet. Polifenolet janë antioksidant potent, ata janë në gjendje të neutralizojnë radikalet e lira. Radikalet e lira janë specie kimike të cilat kanë së paku nga një elektron të pa çiftëzuar dhe në këtë gjendje janë shumë reaktive duke shkaktuar reaksione detyruese në organizëm reaksione të cilat bëjnë çrregullimin e shumë proceseve metabolike. Dëmtimet mund të jenë edhe në qeliza, proteina, etj.

Komponimet fenolike të ngjashme me paracetomolin mund të oksidohen duke përdorur metodat elektrokimike. Forma e zhvillimit të reaksionit kimik të këto komponime varet shumë nga natyra e sipërfaqes së elektrodës. Në përgjithësi shpejtësia e transferimit të elektroneve është e ngadalshme dhe sinjali elektrokimik në përqendrimet të vogla është vështirë ose i pamundur të matet, që çon në zhvillimin e disa metodave të reja rreth modifikimit të sipërfaqeve të ndryshme të elektrodave.

Synimi i hulumtimit tonë ka qenë zhvillimi i sensorëve dhe biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e komponimeve me përbërje fenolike duke vënë theks të veçantë ato për destinim farmaceutik.

Metodat elektrokimike, si voltametria ciklike dhe amperometria hidrodinamike janë përdorur për zhvillimin e sensorëve në fjalë, konkretisht për të hulumtuar sipërfaqet e elektrodave, mekanizmin e reaksioneve redokse, efektet e modifikuesëve, performacën e sistemeve analitike të zhvilluar etj.

Në këtë temë të doktoratës janë arritur të zhvillohen sensor dhe biosensor amperometrik për përcaktimin e komponimeve me përmbajtje fenolike duke vënë theks te veçante ato për destinim farmaceutik. Zhvillimi i sensorëve dhe biosensorëve është arritur duke përdor

materialet nga elektrodave të pastra të karbonit ose duke i modifikuar ato. Modifikimet janë realizuar duke përdorur teknika shumë komplekse dhe interesante me çka është arritur të rritet sinjali analitik dhe mundësia e operimit në potenciale ku interferencat janë minimale. Kjo më pas ka mundësuar të analizohen edhe mostra fiziologjike të cilat përmbajnë matriks mjaft kompleks. Sa i përket elektrodave të punës janë përdorur kryesisht materiale nga karboni si: karbon qelqor, pastë e grafitit, diamant i dopur me bor dhe elektroda të printuara të karbonit. Ndërsa si modifikues është përdorur grafeni, nanotuba të karbonit si dhe enzime (tirozinazë).

Rezultatet e fituara kanë treguar që biosensori elektrokimik që bazohet në përdorimin e elektrodave të printuara të karbonit të llojit DS-150, modifikuar me grafen dhe tirozinazë është shumë efektiv në përcaktimin e paracetamolit në tabletat farmaceutike dhe gjithashtu në mostrat fiziologjike të cilat janë mjaftë komplekse siç është urina, ku përcaktimet janë shpesh herë të vështira. Kështu biosensori në fjalë ka arritur të operojë në potencial 0.00 V, rend linear deri në $130 \mu\text{mol L}^{-1}$, limit të përcaktimit $1.1 \mu\text{mol L}^{-1}$.

Me këtë kontribut gjithashtu është demonstruar sjellja biosensorit amperometrik në analizën e frutave të ndryshme të malit, i përbërë nga pasta e karbonit dhe modifikuar me nanotuba të karbonit dhe tirozinazë. Pas disa hapave të optimizimit është realizuar përcaktimi i sasive totale antioksiduese ekuivalent me Troloksin (TEAC) në dredhëza, manaferra, mjedër, boronicë dhe boronicë e kuqe.

Elektroda e diamantit e dopuar me bor e integruar në sistemin FIA ka treguar të jetë efikase në përcaktimin e sasive totale antioksiduese ekuivalent me Troloksin gjatë analizës së mostrave të çokolatës duke paraqitur një pajisje të thjeshtë analitike për përcaktimin e kualitetit të çokollatës, veçanërisht në përcaktimin e përmbajtjes së kakaos (w/w).

Metodat e zhvilluara janë krahasuar me metoda tjera standarde dhe kanë treguar korrelacion të mirë sa i përket rezultateve gjatë matjeve në mostra reale ose standarde.

SUMMARY

Phenolic compounds in general are a broad class of organic compounds of great importance. They are organic molecules that contain one or more hydroxyl groups in the aromatic ring or rings.

Compounds with phenolic composition are widespread in the living world, and some of them are also synthesized by various industries for specific needs. A large part of phenolic compounds participates in many metabolic processes in our body. They can be metabolized or taken in the form of pharmaceutical tablets.

Acetaminophen, known as paracetamol, is an aminophenol derivative (N-acetyl-p-aminophenol) with analgesic and antipyretic effects. Paracetamol is widely used as a substitute for acetylsalicylic acid and phenacetin.

The use in large doses has been shown to be very harmful to health. Most of the active substance is extracted from the body in the form of non-toxic metabolites in the urine (40-60% as glucuronate, 30% as sulfate), and 2% in unchanged form. These present essential facts for the determination of paracetamol in clinical analyses.

Polyphenols are a large class of chemical compounds found in many plants; these compounds have attracted attention due to the health benefits they possess. More than 8000 compounds are known which have been isolated and described. Polyphenols can be divided into three main groups, flavonoids, phenolic acids, and sibenoids. Polyphenols are potent antioxidants; they are able to neutralize free radicals. Free radicals are chemical species that have at least one unpaired electron and in this state are very reactive, causing secondary reactions in the body, reactions that disrupt many metabolic processes. Damage can also be in cells, proteins, etc.

Phenolic compounds similar to paracetamol can be oxidized using electrochemical methods. The form of development of the chemical reaction in these compounds depends greatly on the nature of the electrode surface. In general, the rate of electron transfer is slow and the electrochemical signal at low concentrations is difficult or impossible to measure, which leads to the development of several new methods around the modification of various electrode surfaces.

The goal of our research has been the development of electrochemical sensors and biosensors for the determination of compounds with phenolic composition, with particular emphasis on those for pharmaceutical use.

Electrochemical methods, such as cyclic voltammetry and hydrodynamic amperometry, have been used to develop the mentioned sensors, specifically to investigate electrode surfaces, the mechanism of redox reactions, the effects of modifiers, the performance of developed analytical systems, etc.

In this Ph.D. topic, amperometric sensors and biosensors have been developed for the determination of compounds with phenolic content, with particular emphasis on those for pharmaceutical use. The development of sensors and biosensors has been achieved using materials from pure carbon electrodes or by modifying them. The modifications were carried out using very complex and interesting techniques, with which it was possible to increase the analytical signal and the possibility of operating at potentials where the interferences are minimal. This has made it possible to analyze even physiological samples which contain a quite

complex matrix. As for working electrodes, mainly carbon materials were used, such as glassy carbon, graphite paste, boron-doped diamond, and printed carbon electrodes. While graphene, carbon nanotubes, and enzyme (tyrosinase) were used as modifiers.

The obtained results have shown that the electrochemical biosensor based on the use of DS-150 printed carbon electrodes modified with graphene and tyrosinase is very effective in the determination of paracetamol in pharmaceutical tablets and also in physiological samples which are quite complex such as it is urine, where determinations are often difficult. Thus, the biosensor in question has managed to operate at a potential of 0.00 V, linear order up to 130 $\mu\text{mol L}^{-1}$, the limit of determination 1.1 $\mu\text{mol L}^{-1}$.

With this contribution, the behavior of the amperometric biosensor in the analysis of different mountain fruits, made up of carbon paste and modified with carbon nanotubes and tyrosinase, has been demonstrated. After several steps of optimization, the determination of total antioxidant amounts equivalent to Trolox (TEAC) in strawberry, blackberry, raspberry, blueberry, and cranberry was carried out.

The boron-doped diamond electrode integrated into the FIA system has been shown to be efficient in the determination of total antioxidant amounts equivalent to Trolox during the analysis of chocolate samples presenting a simple analytical device for the determination of chocolate quality, especially in the determination of cocoa content (w/w).

The developed methods have been compared with other standard methods and have shown a good correlation in terms of results during measurements on real or standard samples.

PJESA TEORIKE

1. KOMPONIMET FENOLIKE

Komponimet fenolike janë klasë e gjerë e komponimeve organike të cilat përmbajnë një ose më shumë grupe hidroksilike (-OH) të lidhura direkt në unazën aromatike. Anëtari më i thjeshtë përfaqësues i komponimeve fenolike është fenoli me formulë kimike C_6H_5OH . Emri sistematik për C_6H_5OH është benzenol, mirëpo emërtimi fenol për këtë komponim është pranuar sipas nomenklaturës IUPAC, ndërsa komponimet që rrjedhin nga zëvendësimi i mëtejshëm në unazën benzenike njihen si derivate të fenolit [1].

Të gjitha atomet e karbonit të cilat formojnë unazën aromatike kanë hibridizim sp^2 . Prandaj, fenoli ka strukturë heksagonale planare, ku të gjitha lidhjet kanë këndë prej 120° me elektrome π të shpërndara të tërë unazën aromatike. Lidhja C-O formohet nga orbitalet $Csp^2 - Osp^2$ ndërsa lidhja O-H formohet nga orbitalet $Osp^3 - Hsp^1$. Dy orbitalet tjera të atomit të oksigjenit janë të okupuara nga dy çiftet elektronike jo lidhëse. Për këtë arsyeje, grupi funksional hidroksil C-O-H ka formë të përkulur me kënd të lidhjes 109.5° siç është paraqitur në Figurën 1.1. Oksigjeni është më elektronegativ se sa atomet e karbonit dhe hidrogjenit, me çka bënë që dy lidhjet C-O dhe O-H të janë polare [2].




Figura 1.1. Struktura e fenolit [4]

Për më tepër çiftet elektronike të atomit të oksigjenit janë të konjuguara me sistemin e unazës aromatike duke shkaktuar transferimin e ngarkesës parçiale negative nga atomi i oksigjenit brenda në unazë, dhe delokalizmin e ngarkesës. Ky efekt ndikon që të grupi O-H të ketë polaritet më të madh, e që si pasojë kemi rritjen e karakterit acidik të fenolit duke mundësuar më pas formimin e joneve fenokside (fenolateve) [2, 3]. Këto karakteristika të përmendura i japin fenolit veti specifike kimike dhe fizike. Në Figurën 1.2 janë paraqitur disa shembuj të komponimeve fenolike.






Figura 1.2. Shembuj të komponimeve fenolike [4]


Emërtimi i derivateve të fenolit bëhet në atë mënyrë që numërimi në unazën aromatike fillon nga karboni që lidh grupin hidroksil në drejtim të karbonit të zëvendësuar më të afërt me karbonin që lidh grupin hidroksil [1].




Përveç emrave sipas nomenklaturës IUPAC, për emërtimin e një numri të konsiderueshëm të komponimeve fenolike përdoren edhe emrat trivialë të tyre siç është rasti me 1,2-benzendioli, 1,3-benzendioli dhe 1,4-benzendioli, të cilët njihen me emrat si pyrokatekol ose katekol, rezorcinoli dhe hidrokinoni.



**1,2-Benzendioli
(Katekoll)**




**1,3-Benzendioli
(Resorcinoli)**




**1,4-Benzendioli
(Hidrokinoni)**


Po ashtu për të treguar pozicionin e zëvendësuar në unazën benzenike shpesh përdoren edhe parashtesat orto-, meta- dhe para- (o-, m-, p-) për pozicionet 2, 3 dhe 4 ndaj karbonit, i cili lidh grupin hidroksil [1, 5].



o-Nitrofenoli



m-Nitrofenoli



p-Nitrofenoli

Në varësi të numrit të grupeve hidroksilike, fenolet mund të klasifikohen si monohidroksilike, dihidroksilike, trihidroksilike dhe polihidroksilike [6].

1.1 Paracetamoli

Që nga kohët e lashta komponimet fenolike natyrale janë përdorur si ngjyrues dhe në mjekësinë tradicionale. Shumë komponime të tilla, natyrale ose jo natyrale, janë evidentuar si ilaçe për trajtimin e kancerit, infeksioneve virusale, astmës, dhe sëmundjeve që janë të lidhura me sistemin nervor [7].




Figura 1.3. Struktura kimike e molekulës së paracetamolit [8].

Acetaminofeni (APAP), i njohur si paracetamol, është një derivat aminofenoli (N-acetil-p-aminofenoli) me efekte analgjetike dhe antipiretike. Paracetamoli përdoret gjerësisht si zëvendësues i acidit acetilsalicilik dhe fenacetinës. Për shkak të çmimit shumë të ulët ky medikament gjen përdorim të gjerë, shpeshherë edhe në mënyrë të pakontrolluar [9-10].

Zakonisht doza për të rritur është një ose dy tableta nga 500 mg deri në pesë herë në 24 orë. Për fëmijë doza maksimale për 8 orë është 500 mg. Edhe përkundër dozës së rekomanduar, ekziston rrezik serioz i helmimit që shkakton dëmtim akut të mëlçisë deri në 42% , më shumë se 300,000 të hospitalizuar për vit. Përdorimi në doza të mëdha është treguar të jetë shumë i dëmshëm për shëndetin. Pjesa më e madhe e substancës aktive ekstrahohet nga trupi në formë të metaboliteve jo toksike në urinë (40-60% si glukuronat, 30% si sulfate), dhe 2% në formë të pandryshuar. Këto paraqesin fakte të rëndësishme për përcaktimin e paracetamolit në analiza klinike [10-12].

Është konfirmuar se APAP në mënyrë reversibile oksidohet në N-acetil-p-benzokinon-iminë (NAPBQI) me participimin e dy elektroneve dhe dy protoneve, siç shihet në figurën 1.3[13-15].




Figura. 1.4. Mekanizmi i propozuar i oksidimit te paracetamolit në formë elektrokimike [13].

Komponimet e ngjashme me paracetamoln mund të oksidohen duke përdorur metodat elektrokimike. Forma e zhvillimit të reaksionit kimik te këto komponime varet shumë nga natyra e sipërfaqes së elektrodës. Në përgjithësi shpejtësia e transferimit të elektroneve është e ngadalshme dhe sinjali elektrokimik në përqendrimet të vogla është vështirë ose i pamundur të matet, që çon në zhvillimin e disa metodave të reja rreth modifikimit të sipërfaqeve të elektrodave të ndryshme [15].

1.1.1 Shembuj të biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit

Përcaktimet e sasive antioksiduese totale janë pjesë me e shpeshtë e analizës kimike, dhe përderisa bëhet analizimi i një grupi të madh molekulash, në fruta të ndryshme kryesisht, bënë më të lehtë zhvillimin dhe konstruktimin e biosensorëve për këtë qëllim edhe pse ka sfida në këtë drejtim. Problemi më i madh qëndron në rastet kur kemi të bëjmë me analizimin e mostrave fiziologjike dhe kemi për ta përcaktuar një analit të vetëm në mesin e shumë të tjerëve (mostra shumë komplekse). Një situatë e tillë është më përcaktimin e paracetamolit në urinë që paraqet sfidën kryesore të këtij hulumtimi. Për këtë qëllim është bërë një hulumtim më në detaje rreth biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit në mostra të ndryshme, për të parë sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të një biosensorit të kohës i cili do të ketë performancë më të lartë se biosensorët paraprak, por edhe për të mësuar rreth teknikave të modifikimit dhe hulumtimit në përgjithësi. Në këtë pjesë do të prezantohen disa hulumtime që janë realizuar rreth zhvillimeve të biosensorëve të tillë elektrokimik, duke i klasifikuar në bazë të entiteteve biologjike të përdorura (fruta, enzima, bakterie etj.)

Përdorimi i indeve të frutave dhe perimeve

Në vitin 2001 është prezantuar një hulumtim i cili ka të bëjë zhvillimin e një biosensori elektrokimik bazuar në përdorimin e pastës së karbonit me inde të avokados (*Persea americana*) si burim i polifenol oksidazës (PPO) [16]. Sensori i tillë është ndërtuar duke përdorur pastën e karbonit si material bazë e më pas duke e modifikuar me inde të avokados në raport 75% me 15% (w/w) dhe 10% material lidhës (vazelinë). Sensori elektrokimik ka qenë i aftë të operojë

ne pH neutral duke përdorur pufer fosfat. Hulumtimi është zhvilluar duke përdorur tretësirë standarde të paracetamolit me pastërti analitike ose edhe të produkteve farmaceutike të paracetamolit për të dhënë informacione rreth performancës së sensorit dhe krahasuar rezultatet.

Teknika me të cilën është janë zhvilluar matjet kanë qenë kronoamperometria hidrodinamike duke përdorur mënyrën e akumulimit të analitit pranë sipërfaqes së elektrodës me përzierje të vazhdueshme dhe pas ndërprerjes së përzierjes, elektroda është polarizuar në potencial operues $-0.12V$ vs $Ag/AgCl$. Sensori i konstruktuar në mënyrë të tillë ka treguar rezultate të mira në testet për “recovery” në produkte të ndryshme që përmbajnë paracetamolit.

Përveç avokados, bananet, patatet, mollët, arrat e kokosit, kërpudhat, patëllgjani i zi etj., përmbajnë tirozinazë ose enzimë polifenol oksidazë (PPO). PPO katalizojnë dy lloj procese, o-hidroksilimin e monofenoleve në o-difenole dhe oksidimin e tyre në kinone përkatëse. Më tutje do të shtjellohet përdorimi i patëllgjanit të zi dhe i banave si burim i PPO në kuadër të zhvillimit të biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit.

Një biosensor elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit duke përdorur patëllgjanin e zi si burim i PPO [17] është ndërtuar duke bërë përzierjen e pastës së karbonit më ekstrakt të patëllgjanit të zi.

Pasta e tillë është vendosur në piston dhe teknika më të cilën është bërë matja elektrokimike ka qenë voltametria me puls diferencial (DPV) duke e përdorur biosensorin elektrokimik si elektrodë e punës dhe si elektrodë referente $Ag/AgCl$ 3M, ndërsa teli i platinës ka shërbyer si elektrodë ndihmëse. Biosensori ka operuar në pH 6.0 (aktivitet maksimal enzimatik) dhe pH 7.0 (stabilitet maksimal). Rendi linear për sensorin ka qenë 20-200 μM me limit të detektimit 5 μM . Aplikimi i sensorit për përcaktimin e paracetamolit në tableta dhe tretësirat orale ka treguar rezultate të kënaqshme, me vlera të RDS 1.26-1.72 %, ndërsa për “recovery” për paracetamol in ka variruar nga 97.% deri 99.8% për përcaktimet voltametrike.

Kur jemi tek përparësitë e një biosensori elektrokimik faktorë i rëndësishëm është edhe sasia e mostrës që duhet marr për analizë, është shumë me interes që sasia të jetë sa më e vogël. Një biosensor i tillë elektrokimik është paraqitur [18] i cili mund të operojë në nivel të mikrolitrave saktësisht me një mikrolitër. Biosensori i tillë është zhvilluar duke e përdorur si bazë pastën e karbonit e cila është modifikuar me hidrogjel (polimer) dhe inde të bananes. Hidrogjeli është përgatitur duke kombinuar akril amidën dhe acidin akrilik si dhe si lidhës i tyre është shtuar N,N-metilen bisakrilamida, ky lloje hidrogjeli ka pasur rolin e absorbuesit ndërsa indet e bananës kanë shërbyer si burim i PPO. Elektroda e tillë e modifikuar ofron limit të detektimit të ulët (1.6 μM) me rend linear 10-250 μM , riprodhueshmëri të mirë dhe stabilitet në dy mjediset, atë acidik dhe bazik, si dhe jetëgjatësi të madhe të enzimës (20 ditë).

Frutat Jurubeba (*Solanum paniculatum* L.) raportohen që përmbajnë gjithashtu PPO dhe të tillat janë përdorur gjithashtu si burim i komponentës biologjike për të zhvilluar biosensor elektrokimik [19]. Ky sensor është testuar duke përdorur paracetamol in, acidin acetil salicilik, metil dopan dhe acidin askoribik. Performancë më e mirë është arritur në testimet me paracetamol me rend linear 5 deri 245 μM ($R = 0.9994$), limit të detektimit 3 μM dhe rend të përsëritshmërisë në mes 1.52 % dhe 1.74 % (RSD). Gjithashtu edhe kungulleshat iu bashkëngjiten grupit i cili përmban burim të PPO [20].

Përdorimi i enzimave për zhvillimin e biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit

Një mekanizëm tjetër përmes të cilit është arritur të bëhet përcaktimi i paracetamolit është duke e përdorur enzimën aril acilamidazën e cila konverton paracetamol in në 4-aminofenol [21].

Produkti i fituar më pas është oksiduar duke aplikuar potencial +0.25 V në elektrodën e punës vs Ag/AgCl elektrodës referente. Biosenzori i tillë elektrokimik është përdorur për të përcaktuar paracetamolën në plazmën e gjakut. Si problem në përcaktim sipas autorëve është prezenca e tiroleve të cilat mund të lidhen me produktet e oksiduara duke i reduktuar prapë ato, e që të tillat më pas ato arrijë të oksidohen prapë në elektrodë duke gjeneruar sinjal elektrokimik shtesë. Amidaza si enzimë është përdorur edhe si bashkë modifikues me ceriumin dhe dioksidin e grafenit në sipërfaqe që printuara nga nanotubat e karbonit[22].

Lakaza është përdorur për të modifikuar sipërfaqet e elektrodave të paktën dy herë në funksion të zhvillimit të biosensorëve për ta përcaktuar paracetamolën [23-24]. Në rastin e parë pasta e karbonit është modifikuar me lakazë dhe dioksid të titanit. Rezultatet kanë treguar se ky biosensor elektrokimik është shumë i ndjeshëm dhe gjithashtu selektiv për të përcaktuar paracetamolën. Matjet janë zhvilluar duke përdorur voltmetrinë me puls diferencial, rend linear 8 deri 120 μM dhe kufi shumë të ulët të detektimit 1 μM [23].

Në rastin tjetër si material bazë është përdorur elektroda e karbonit qelqor e cila fillimisht është modifikuar me nanotuba të karbonit e në fund me lakazë e cila është lidhur me sipërfaqen e elektrodës duke shtuar glutaraldehyd i cili ka rol lidhës. Sipërfaqja e modifikuar është dhe ajo e pa modifikuar është fotografuar me mikroskop elektronik për të paraqitur dhe argumentuar ndryshimet. Është përdorur Voltmetria ciklike, voltmetria me puls diferencial dhe ajo me valë kuadratike për të zhvilluar matjet analitike. Për dallim nga biosenzori paraprak i fundit ka kufi të detektimit më të lartë 7 μM [24].

Biosensorët tjerë për përcaktimin e paracetamolit

Biosensorët elektrokimik përdorin entitete të ndryshme biologjike duke përfshi edhe bakteriet. *Bacillus spp* është një bakterie e cila përmban polifenol oksidazë, metalproteina të cilat katalizojnë procesin e oksidimit të fenoleve dhe polifenoleve. Përdorimi i një entiteti të tillë në konstruktimin e biosenzorit elektrokimik është paraqitur [25]. Teknika e zhvillimit të këtij biosenzori duket interesante e cila konsiston në përdorimin e elektrodës së arit e cila më pas modifikohet me nanotuba të karbonit shumë shtresor të karboksiluara së bashku me anilinën. Modifikimi është kryer duke bashkuar në një tretësirë të vetme të këto dy substancave dhe duke i depozituar ato në mënyrë elektrokimike në sipërfaqen e elektrodës. Në fund elektroda është modifikuar me bakterie dhe sipërfaqja përfundimisht është mbuluar me glutaraldehyd. Në mekanizmin e propozuar paracetamolit oksidohet në o-kinone korresponduese nga polifenol oksidaza e ndihmar nga shtresa e cila përmban nanotuba shumë shtresor dhe polianilinën (Au/PANI-cMWCNT/*Bacillus sp./GA*) dhe më pas duke u reduktuar elektrikimisht të o-kinoneve, në këtë mënyrë duke formuar cikël amplifikues biokatalitik dhe duke gjeneruar elektrone. Elektronet më pas pranohen nga MWCNT/PANI për ta formuar formën e tyre të reduktuar, më vonë MWCNT/PANI oksidohet duke liruar elektrone e që migrojnë drejt sipërfaqes së arit ku dhe formojnë rrymën apo sinjalin analitik. Rryma e matur ka qenë proporcionale me sasinë e paracetamolit. Biosenzori është testuar në analizat e mostrave reale duke përdorur disa produkte të paracetamolit dhe gjithashtu përgjigjja e sensorit ndaj analitëve tjerë.

Ari është material i rëndësishëm për ndërtimin e biosensorëve elektrokimik. Në sipërfaqen e arit mund të lidhjen molekula të ndryshme (kryesisht tirole ose aminoacide) me lidhje kovalente në mënyrë spontane ose elektrokimike. Me lidhjen e molekulave siç janë aminoacidet formohen kushte të favorshme që të lidhjen edhe makromolekula tjera me theks të veçantë acidet nukleike dhe enzimet. Teknikë e tillë është përdorur për ta parë sjelljen elektrokimike të paracetamolit dhe për ta përcaktuar atë [26]. Biosenzori elektrokimik është zhvilluar në atë mënyrë ku fillimisht elektroda e arit është modifikuar me cistinë dhe në fund është shtuar acidi desoksiribonukleik (ADN). Ky biosensor elektrokimik operon në pufër fosfat, me kufi të detektimit 7.8 μM , rend linear 65-730 μM . Është testuar gjithashtu edhe për interferencat e

mundshme. Në mostrat fiziologjike zakonisht të pranishme i kemi acidin askorbik dhe acidin urik, por që nuk kanë treguar të jenë ndonjë problem në përcaktim.

1.2 Polifenolet

Polifenolet janë klasë e madhe e komponimeve kimike të cilat gjenden në shumë bimë, këto komponime kanë tërhequr vëmendjen për shkak të mirave shëndetësore që i posedojnë [27]. Janë të njohura më shumë se 8000 komponime të cilat janë izoluar dhe përshkruar [28]. Polifenolet mund të ndahen në tri grupe kryesore, flavonoidet acidet fenolike dhe sibenoidet. Flavonoidet janë prej polifenoleve të cilat janë izoluar më së shumti, ato posedojnë dy ose më shumë unaza aromatike ku secila bartë nga një ose më shumë grupe hidrokasilike dhe në mes vete janë të lidhura përmes një urë oksigjeni. Flavonoidet varësisht nga pozita e unazave aromatike ndahen në disa nën klasa të cilat janë quajtur flavone, izoflavone, antoksinidinë, kalkone dhe dihidrokalkone [29, 30].




Figura 1.5. Struktura e disa polifenoleve të cilat gjinden në bimën të ndryshme

Acidet fenolike zakonisht ndahen në dy klasa kryesore, nga acidi benzoik që përmban 7 atome të karbonit ose nga acidi cianimik me 9 atome të karbonit [31]. Të gjitha këto komponime janë të hidrosiluara. Të gjitha këto komponime gjenden në bimë të cilat mund të jenë të esterifikuar me glukozë ose karbohidrate tjera. Polifenolet dietike janë të izoluar nga frutat (manaferrat, mollët, agrume, qershi); perime (qepë, selino fasule), barëra, rrënjët, erëza (xhinko, shafran i Indisë); çaj të gjelbër dhe të zi [32]. Dihet se konsumi i ushqimeve të pasura me flavonoide, veçanërisht tek frutat dhe perimet, përkthehet në përfitime për shëndetin e njeriut: Studimet epidemiologjike kanë gjetur se praninë e këtyre komponimeve është e lidhur ngushtë me zvogëlimin e sëmundjeve të zemrës, kancerit, sëmundjeve gastrointestinale dhe neurologjike, alergjitë etj. [28, 31, 33-35].

Polifenolet janë antioksidant potent, ata janë në gjendje të neutralizojnë radikalet e lira. Radikalet e lira janë specie kimike të cilat kanë së paku nga një elektron të pa çiftëzuar dhe në këtë gjendje janë shumë reaktive duke shkaktuar reaksione dytësore në organizëm reaksione të cilat bëjnë çrregullimin e shumë proceseve metabolike. Dëmtimet mund të jenë edhe në qeliza, proteina, etj [29, 36].

Komponimet fenolike kanë demonstruar të jenë antibakteriale, antitoksina, antivirale si dhe gjithashtu të tregojnë aktivitet antifungal. Si përfundim mund të citojmë Halliwell i cili thotë: "Flavonoidet dhe komponimet tjera polifenolike kanë efekt të fuqishëm antioksidativ *in vitro*, por mund të veprojnë si pri-oksiant në disa sisteme tjera. Komponimet fenolike ndihmojnë mbrojtjen e trakti gastrointestinal ndajë dëmtimeve të mundshme nga speciet reaktive që janë prezent në ushqim ose që mund të formohen më vonë në stomak ose zorrë. Përfitimi i përgjithshëm shëndetësor i flavonoids është e pasigurt, dhe konsumimi i sasive të mëdha të tyre në ushqime të pasuruara nuk duhet ende të inkurajohen" [37-41].

Çokolata është një produkt ushqimor nga kakao e cila në përgjithësi klasifikohet në tri grupe: çokolata e zezë, çokolata nga qumështi dhe çokolata e bardhë. [42-44]. Çokolata e zezë përmban zakonisht 50-90% kakao, gjalpë të kakaos sheqer, ndërsa çokolata nga qumështi përmbajnë 10-50 % kakao, gjalpë të kakaos, qumësht në forma të ndryshme dhe sheqer. Çokolata e bardhë nuk përmban sasi të kakaos [44]. Autoritet Çeke të Bujqësisë dhe Ushqimit kanë raportuar se një pjesë e prodhuesve nuk bëjnë deklarin e saktë të sasisë sa kakaos në produktet e çokolatave[45]. Kakao përmban sasi të larta të polifenoleve dhe është e mundur të bëhet përcaktimi i tyre me metoda elektrokimike në kontekstin e analizës së kualitetit të çokolatës dhe kapacitet antioksidues total (TAC)[46-50].

Metodat analitike për përcaktimin e polifenoleve (kapacitetit antioksidues)

Troloksi është një analog sintetik i α -tokoferolit, i njohur si forma më aktive e vitaminës E , i cili përdoret si substancë standarde për krahasimin e aktivitetit antiradikal në ushqim i shprehur si kapaciteti antioksidues ekuivalent me Trolaksin (TEAC) [51]. Tretshmëria e Troloksit në pH neutrale është $3 \text{ mg} \cdot \text{mL}^{-1}$, që është e mjaftueshme për analizat e zakonshme. Për përcaktimin e TEAC disa metoda spektrometrike janë zhvilluar duke u bazuar në vetitë reduktuese nga prezenca e antioksidantëve. Një nga metodat më të shpeshta, 1,1-difenil-2-pikrilhidrazil(DPPH) është e bazuar në radikal 1,1-difenil-2-pikrilhidrazil (DPPH) [52]. Disa metoda tjera janë përdorur në analizën e frutave, duke përfshirë një radikal oksigjenik me kapacitet absorbues (ORAC) [53], aftësia antioksiduese e reduktimit ferrik (FRAP) [54], dhe bllokimi total radikal i potencialit antioksidues (TRAP) [55]. L-acidi askorbik(AA), i njohur si vitamina C, është i njohur si një komponim kimik jofenolik, i cili gjendet gjithashtu në fruta me kapacitet të lartë antioksidues [56], ku zakonisht gjendet së bashku me polifenolet në gjëra ushqimore. AA ka efekt pengues gjatë matjeve në analizat elektrokimike të polifenoleve për shkak të vetive reduktuese (kinonet reduktohen sërish në polifenole). Efekti interferues i AA në përcaktimin e hidrokinonit (HQ) që ka strukturë të ngjashme me α -tokohidrokinonet [57], i njohur edhe nga studimet paraprake [58].




Figura 1.6. Mekanizmi i propozuar i reduktimit të hidrokinonit nga acidi askorbik [49].

Mekanizmi i reduktimit të hidrokinonit nga AA, i propozuar nga ISAACS dhe ELDIC është paraqitur në figurën 1.6 [58], Sidoqoftë më herët është gjetur se prezenca e AA nuk interferon në raportin molar të AA me HQ 1:1, në rastet e biosensorëve amperometrik bazuar në elektrodë pastë karboni modifikuar me tirozinazë (TYR) [59].

1.3 Tirozinaza

Tirozinaza është një glikoprotein cila përmban bakër me masë 75 kD, e njohur si molekula T4. I përket familjes së proteinave që kanë qendër katalitike të formuar nga dy bërthama bakër lloji-3. Kjo enzimë katalizon hidrosilimin e monofenoleve në pozitat orto dhe rrjedhimisht oksidimin e difenoleve në kinone përkatëse[60]. Këto reaksione ndodhinë në prani të oksigjenit i cili reduktohet në ujë. Kinonet si produkte janë prekursor reaktiv për sintezën e melaninës.




Figura 1.7. Forma strukturore e tirozinazës (majtë) dhe pjesa aktive e saj (djathtë) [62].

Tirozinaza e cila gjendet në perime, fruta dhe kërpudha, është një enzimë e cila ndikon në nxirjen e tyre kur ato ruhen për një kohë të gjatë. Tek gjitarët tirozinaza është përgjegjëse për anomalitë në pigmentimin e lëkurës[61]. Kështu tirozinaza është mjaftë e rëndësishme në fushën e bujqësisë dhe industrisë. Në industrinë kozmetike zhvillimi i inhibitorëve potent të tirozinazës është një interes atraktiv.

Aftësia e tirozinazës për të reaguuar me fenole bënë atë të përdorshme në bioteknologji, për zhvillimin e biosensorëve dhe aplikimet në biokatalizë [63-65].

Në vitin 2003 është realizuar një studim kinetik i oksidimit të APAP nga tirozinaza (EC 1.14.18.1) [66].

Në hapin e parë APAP hidrosilohet duke kaluar në 4-acetamido-1,2-katekoll. Më pas ky produkt inermiediar në hapin e dytë oksidohet në 4-acetamido-o-benzokinon(4-AOBQ) [67, 68]. Produkti i fituar (4-AOBQ) mund të reduktohet në mënyrë elektrokimike me participimin e dy protoneve dhe dy elektroneve [69].




Figura 1.8. Mekanizmi i oksidimit të hidrokinonit nga tirozinaza [59].

Tirozinaza është e aftë të katalizojë edhe oksidimin e troloksit me çka formohet Troloks kinoni [59], i cili ka mundësi të reduktohet elektrokimikisht më pjesëmarrjen e dy elektroneve dhe dy protoneve në Troloks hidrokinone[69]. Këto procese përshkruajnë në mënyrë të thjeshtë principin e sjelljes së biosensorit amperometrik nga tirozinaza.

2. SENSORËT

Termi sensor filloj të përdoret nga vitet 70-ta. Ky zhvillim ishte i shkaktuar nga zbulimet teknologjike që ishin pjesë e revolucionit industrial që vazhdon edhe në ditët e sotme [70]. Sensorët janë pajisje që mundësojnë konvertimin e parametrave të ndryshëm siç janë ata kimik ose fizik në sinjale të matshme dhe të përshtatshme. Rrjedhimisht, sensorët kimik mund të konsiderojmë si gjuhë dhe hundë artificiale. Parimi i sensorëve është i ngjashëm me organet sensitive të organizmave të gjallë [71]. Sensorët sot janë pjesë e pothuajse të gjitha makinerive dhe aparaturave të ndryshme, ata janë sytë dhe veshët e tyre. Ata kanë ndihmuar që aparaturat dhe makineritë të bëhen më “inteligjente” dhe më të pavarura. Me zhvillimin gjithnjë në rritje të teknologjisë dhe automatizimit, njëherësh edhe sensorëve, mund themi se sot sensorët paraqesin organet teknike të ndijimit si: sytë, veshët dhe gjymtyrët e makinerive të automatizuara[70]. Figura 2.1 ilustron ngjashmëritë mes sistemeve biologjike dhe teknike.




Figure 2.1. Procedimi i sinjalit nga organizmat e gjallë dhe procedimi nga një makinë inteligjente [70].

Karakteristika më e rëndësishme e një sensori ideal është që ai të bëjë të mundur matjen në mënyrë të vazhdueshme pa mostrim dhe pa modifikuar matjen apo analitin. Ky është dallimi kryesor ndërmjet sensorëve kimikë dhe pajisjeve analitike që përdoren në kiminë analitike. [72].

2.1. Sensorët kimikë

Një sensorë kimik është një pajisje e vogël dhe e kompletuar që në një kohë reale e kthen informacionin kimik në një sinjal të përdorshëm analitik. Sipas Bashkimit Ndërkombëtar të Kimisë të Pastër dhe të Aplikuar (IUPAC) sensorët kimikë përkufizohen si pajisje që transformojnë informatat kimike, duke filluar nga përqendrimi i një komponente specifike deri në analizën totale të përbërjes, në sinjal analitik të shfrytëzueshëm. Funksionimi i sensorit kimik bazohet në pjesët përbërëse të tij, si: receptori dhe shndërruesit [73]. Nga informacioni kimik në kuptojmë përqendrimin e një analiti specifik i cili është pjesë e një mostre të caktuar.[74]. Fillimisht kimistët hezituan që të merren me sensorë, por më vonë interesimi i tyre për ta u rrit.

Sensorët nuk përshtaten lehtë me konceptet tradicionale dhe rezultojnë që tu përkasin një fushe të re. Megjithatë nuk ka dyshim se sensorët kimikë përfshijnë një degë të kimisë analitike. Sensorët kimikë janë pajisje të vogla që përmbajnë një element njohës, një element shëndërrues dhe një procesor të sinjalit të aftë që në mënyrë të vazhdueshme dhe të kthyeshme të raportojë për një përqendrim kimik. Sensorët kimikë duhet të jenë të aftë të:

- Transformojnë sasi të kimike në sinjale elektrike
- Të përgjigjen shpejt
- Të ruajnë aktivitetin e tyre për një periudhë të gjatë kohore
- Të jenë të vegjël
- Të jenë të lirë
- Të jenë specifike p.sh. ata duhet t'u përgjigjen vetëm një analiti, ose të paktën të jetë selektiv ndaj një grupi të analitëve [71].

Funksionimi i sensorit kimik bazohet në pjesët përbërëse të tij, si: **receptori** dhe **shëndërruesit**. Receptori i sensorit transformon informatat kimike në formë të energjisë e cila mund të matet nga shëndërruesi [73]. Në shumicën e sensorëve kimikë, receptori reagon me molekulat e analitit. Si rezultat, vetitë fizike të tij ndryshojnë në atë mënyrë që shëndërruesi që është i lidhur mund të fitojë një sinjal elektrik. Në disa raste, objekti i njëjtë sillet si receptor dhe si shëndërrues [70]. Pjesa e receptorit të sensorit kimik mund të bazohet në parime të ndryshme si: fizik, ku nuk zhvillohet reaksion kimik, kimik, në të cilin reaksioni kimik i analitit jep sinjal analitik dhe biokimik, në të cilin procesi biokimik është burim i sinjalit analitik.

Shëndërruesi është pajisje që bën të mundur transformimin e energjisë bartëse të informacionit kimik rreth përmbajtjes së mostrës në sinjal analitik të dobishëm. Shëndërruesi nuk paraqet selektivitet [76].

Klasifikimi i sensorëve realizohet në mënyra të ndryshme. Më i përhapur është klasifikimi që ndjek principet e shëndërruesit të sinjalit.

Grupet e sensorëve rezultojnë:

- Sensorët optikë, që matin absorbancën, reflektimin, luminoshencën, fluoroshencën, indeksin e thyerjes, efektin optotermik dhe shpërhapjen e dritës.
- Sensorët elektrokimikë, në mesin e tyre pajisjet voltametrike dhe potenciometrike, CHEMFET, dhe sensorët potenciometrik për gaze me elektrolitë të ngurtë.
- Sensorët elektrikë duke përfshirë këtu ato okside të metaleve dhe gjysmëpërçuesit organikë si dhe sensorët elektrolitikë të përçueshmërisë.
- Sensorët e ndjeshëm ndaj masës p.sh. pajisjet piezoelektrike dhe ato të bazuara në valët akustike të sipërfaqes
- Sensorët magnetikë (shumica për oksigjen)
- Sensorët termometrikë që bazohen në matjen e efektit të nxehtësisë të një reaksioni specifik kimik ose adsorbimit që përfshin analitin
- Sensorët e tjerë, sidomos ata që bazohen në emisionin ose absorbimin e rrezatimit [70].




Figura 2.2 Paraqitja skematike e një sensori tipik kimik.

Prej parametrave kryesorë që mund të përdoren për të karakterizuar performancën e sensorit kimik janë: ndjeshmëria (sensitiviteti), kufiri i detektimit, rendi dinamik, selektiviteti, lineariteti, rezolucioni, kohë-reagimi, histereza, qëndrueshmëria (stabiliteti) dhe jetëgjatësia [72].

2.2. Sensorët elektrokimik

Sensorët e bazuar në vetitë e tyre elektrokimike janë një grup i veçantë i pajisjeve analitike të cilët kanë tërhequr një vëmendje të konsiderueshme në kohët e sotme dhe e gjithë kjo nuk është e çuditshme duke u bazuar në faktin që këto lloj pajisjesh luajnë një rol kyç në analizat mjekësore dhe klinike, në kontrollin e ushqimit dhe në monitorimin industrial [77]. Sensorët elektrokimikë paraqesin një nënklasë të rëndësishme të sensorëve kimikë në të cilët si element shndërrues përdoret elektroda. Sensori elektrokimik është celulë elektrokimike, e ndërtuar nga dy apo tri elektroda. Varësisht nga parametri elektrik i matur, sensorët elektrokimikë mund të klasifikohen në tipa (lloje) të ndryshëm [78].

Sensorët elektrokimikë në mënyrë të menjëhershme prodhojnë sinjale elektrike. Kjo është njëra prej përparësive kryesore të tyre dhe është njëra prej arsyeve për lidhjen e ngushtë midis fushës së sensorëve kimikë në njërin anë dhe elektrokimisë duke përfshirë teknikat e eksperimenteve elektrokimike në anën tjetër. Elektrokimistat tradicionalisht janë vetë-ndërtues të instrumenteve elektronike. Për shkak të natyrës së punës së tyre, ata duhet të kuptojnë se si instrumentet elektronike punojnë. [70].

Sensorët potenciometrik bazohen në matjen e potencialit, si sinjal relativ, i matur ndaj potencialit të elektrodës referente, që është proporcional me aktivitetin e joneve të analitit në tretësirë. Potenciali i elektrodës referente është vlerë fikse dhe aktiviteti i tretësirës së brendshme të elektrodës referente është konstant. Sensorët amperometrik e gjenerojnë sinjalin analitik nga matja e rrymës që prodhohet nga reaksioni elektrokimik i zhvilluar në sipërfaqe të elektrodës. Potenciali konstant i ushtruar shërben si forcë shtytëse për reaksionin e transferimit të elektroneve të llojeve (specieve) elektroaktive. Kjo mund të përshkruhet edhe si “shtypje e elektroneve” që i shtynë llojet (speciet) të marrin apo të japin elektrone. Rryma rezultuese është matje direkte e rendit të reaksionit të transferimit të elektroneve. Sensorët konduktometrikë bazohen në matjen e përcjellshmërisë (konduktivitetit) të tretësirës, i cili është proporcional me përqendrimin e analitit. Sensorët amperometrikë krahasuar me sensorët tjerë elektrokimikë kanë disa përparësi si: ndjeshmëri të lartë, selektivitet ndaj specieve elektroaktive, rend linear të gjerë, instrumentim në miniaturë dhe çmim të lirë, aftësi për specie të ndryshme, dhe shumë lloje të elektrodave që mundësojnë analizën në mjedise të ndryshme. Në tabelën 2.1 është paraqitur tabela me llojet senzorit elektrokimik dhe principi i punës që kanë ata [79].

Tabela 2.1: Principet e shndërrimit dhe teknikat e matjes të sensorëve elektrokimike [70].

| Sensori | Principi i shndërruesit | Madhësia që matet |
|-------------------------------|-------------------------|--|
| Potenciometrik | Shndërrimi i energjisë | Potenciali(impedanca e lartë) |
| Amperometrikë dhe Kulometrikë | Rryma kufizuese | Rryma (impedanca e ulët) |
| Konduktometrikë | Resistive | Rezistenca(vlera reciproke e përçueshmërisë) |

2.3 Biosensorët elektrokimikë

Biosensorët janë sensor kimik në të cilët sistemi njohës i tyre bazohet në një reaksion biokimik ose biologjik ku qëllimi kryesor i këtij sistemi njohës është që ti garantoj sensorit një nivel të lartë të përzgjedhshmërisë gjatë matjes së analitit. [80, 81].

Biosensorët janë pajisje të cilat komponentën biologjike të imobilizuar e kanë të lidhur direkt me e sinjalit dhe shndërruesin amplifikatorin elektronik. Funkzioni kryesor i shndërruesit është që t'i konvertojë ndryshimet fiziko-kimike të materialit biologjik gjatë bashkëveprimit me analitin nëpërmjet sinjalit dalës [82].




Figura 2.3. Parimi i punës së një biosensori elektrokimik [83].

Njohja Biologjike bazohet në parimin çelës në shumicën e rasteve. Kjo nënkupton se molekulat arrihen të detektohen në bazë të madhësisë së tyre. Selektiviteti i një biosensori është shumë i madh. Substanca bioaktive nganjëherë mund të detektojë analitin në mesin e milionave të tjerë. [70]. Biosensorët sipas Bashkimit Ndërkombëtar të Kimisë të Pastër dhe të Aplikuar (IUPAC) janë sensorë kimikë të cilët si pjesë njohëse përdoret një entitet biologjik si p.sh. enzimë, proteinë, qelizë, ind apo organele[84]. Selektiviteti i lartë i biosensorëve arrihet duke përdorur ndërmjetës selektiv ndaj analitit i cili përmban substancë bioaktive siç janë enzimet, antitruapat apo mikroorganizmat, etj.. Shfrytëzimi i substancave bioaktive të cilat kanë specificitet të lartë për analitin, praktikisht bëjnë që sensorit të jetë i lirë nga interferencat. Në varësi të llojit të shndërruesit të përdorur, biosensorët ndahen në: biosensorë optikë, kalorimetrikë, piezoelektrikë dhe elektrokimikë. [75]. Biosensorët punojnë si sensor biokatalitik ose si sensor me bioafinitet, Në sensorët biokatalitik në shumicën e rasteve enzimët përdoren si komponentë biologjike në sipërfaqen e elektrodës. Tek ata me bioafinitet si grup i dytë zakonisht komplekse shumë stabile me molekulat e mostrës formohen dhe mbahen fuqishëm për sipërfaqe të elektrodës. Në sensorët bioafinitiv në shumicën e rasteve antitruapat ose antigjet vendosen si realizues të reaksionit biokimik. Acidet nukleike gjithashtu mund të klasifikohen si një grup tjetër i biosensorëve [70]. Biosensorët mund të aplikohen në shumë lloje të mostrave duke përfshirë lëngjet trupore, mostrat e ushqimit, mostrat ambientale etj.

Për të konstruktuar një biosensor të suksesshëm duhet plotësuar disa kushte:

1. Substanca biologjike duhet të jetë shume specifike dhe të jetë e qëndrueshme në kushte normale të ruajtjes si dhe në kushtet ku zhvillohet eksperimenti.
2. Reaksioni duhet të zhvillohet sa më i pavarur dhe të mos varet nga kushtet fizike siq është përzierja, vlera e pH dhe temperatura. Kjo do të mundëson që mostra që analizohet të mos i nënshtrohet para trajtimeve.
3. Përgjigjja duhet të jetë e saktë, precize, e riprodhueshme dhe të kemi lineariteti tek koncentriket që neve na interesojnë pa pasur nevojë për hollim ose koncentrik të mostrës.
4. Nëse biosensori përdoret monitorime bioklinike elektroda e punës duhet të jetë efikase dhe e përshtatshme, të mos ketë mundësi të shkaktojë ndonjë pasojë si helmimi ose diçka tjetër.
5. Për mostrat që duhet analizohen shpejtë sensori duhet të jap përgjigje në kohë reale.
6. Si përfundim ndërtimi i sensorit duhet të kushtoj sa më pak të jetë e mundur dhe të mund të përdoret edhe nga personat që nuk janë specialistë të kësaj fushe [85].

2.4. Voltametria dhe amperometria

Metodat elektroanalitike të cilat matet rryma në varshmëri të potencialit të aplikuar quhen metoda voltametrike. Në aspektin historik voltametria është zhvilluar nga polarografia, të cilën e ka zbuluar kimisti çek Heyrovski në vitet e shekullit të XX (1922). Polarografia dallohet nga llojet tjera voltametrike me faktin se elektroda e punës është një elektrodë pikuese e merkurit [86, 87].

Metodat elektroanalitike kanë gjetur aplikim të gjerë përdorim të gjerë për qëllime analitike duke përfshi monitorimin e mjedisit, kontrollin e cilësisë në industri, analiza biomjekësore, etj., si pasojë e thjeshtësisë dhe kostos së ulët, ndjeshmërisë së lartë, mundësin që të automatizohen lehtë dhe ofrojnë një përzgjedhshmëri të kënaqshme. [88].

Termi i përgjithshëm ‘voltmetri’ përfshin në vetvete të gjitha metodat që bazohen në vlerësimin e lakoreve rrymë-potencial. Voltametria është teknikë me kontrollim të potencialit, ku potenciali është i ndryshueshëm krahasuar me amperometrinë të e cila potenciali i ushtruar është konstant. Potenciali i ushtruar kontrollon përqendrimin e specieve redokse në sipërfaqe të elektrodës (C_O^0 dhe C_R^0) dhe rendin e reaksionit (k^0), të përshkruara sipas ekuacionit të Nernst-it ose Butler–Volmerit. Në rastet kur procesi i difuzionit luan rolin kontrollues, rryma rezultuese nga procesi redoks (e njohur si rryma faradeike) është e lidhur me fluksin e materialit drejt ndërfaqes elektrodë-tretësirë dhe është shpjeguar me ligjin e Fikut (Fick).

Për reaksionin elektrokimik reversibël, i cili mund të përshkruhet si $O + ne \rightleftharpoons R$, aplikimi i potencialit E imponon përqendrime përkatëse të O dhe R në sipërfaqe të elektrodës (c_O^0 dhe c_R^0) në përputhje me ekuacionin e Nernst-it:

$$E = E^0 - \frac{RT}{nF} \ln \frac{c_R}{c_O} \quad (2.1)$$

ku:

R - është konstantja universale e gazeve ($8.3144 \text{ J mol}^{-1}K^{-1}$), T është temperatura absolute (K),

n - është numri i elektroneve të këmbjera,

F - konstantja e Faradeit (Faradey) ($96,485 \text{ C/mol}$), dhe

E^0 - është potenciali redoks standard për çiftin redoks.

Nëse ndryshon potenciali i ushtruar në elektrodë, raporti c_R/c_O^0 në sipërfaqe gjithashtu do të ndryshojë që të kënaqë ekuacionin (2.1).

Për disa teknika është e mjaftueshme të përdoret raporti që lidh variablat për rrymën, potencialin dhe përqendrimin e njohur si ekuacioni i Butler–Volmerit:

$$\frac{i}{nFA} = k^0 = \{c_O^0 \exp[-\alpha\theta] - c_R^0 \exp[1-\alpha] \theta\} \quad (2.2)$$

ku

$\theta = nF(E - E^0)/RT$,

k^0 rendi i konstantës heterogjene,

α është koeficienti i transferimit dhe

A është sipërfaqja e elektrodës.

Ky raport bën të mundur që të fitohen vlerat për dy parametra analitikë mjaft të rëndësishëm si i dhe k^0 . Përfundimisht, në shumë raste rrjedha e rrymës varet drejtpërdrejtë nga fluksi i materialit në sipërfaqe të elektrodës. Kur O ose R krijohet në sipërfaqe, rritja e përqendrimit siguron shtytje për difuzionin drejt thellësisë së tretësisë. Gjithashtu, kur O ose R zërthehen, zvogëlimi i përqendrimit ndihmon difuzionin e materialit të ri nga brendia e tretësisë. Gradienti rezultues i përqendrimit dhe transporti i masës janë përshkruar përmes ligjit të Fikut, i cili pohon se fluksi i materies (Φ) është në përpjestim të drejtë me gradientin e përqendrimit:

$$\Phi = -AD_0 = \left(\frac{dc_0}{dx} \right) \quad (2.3)$$

ku:

D_0 është koeficienti i difuzionit

O dhe x janë distancat nga sipërfaqja e elektrodës.

Ekuacioni analog mund të shkruhet edhe për R. Fluksi për O ose R në sipërfaqe të elektrodës kontrollon rendin e reaksionit, kështu që rryma faradeike rrjedh nëpër celulë [89].

Një set tipik i pajisjeve për analiza voltametrike përbëhet nga një sistem prej tri elektrodash, të njohura si elektroda e punës, elektroda referente dhe elektroda ndihmëse si dhe një burim i rrymës dhe pajisja për matjen e rrymës dhe tensionit. Në metodat voltametrike si elektrodë pune përdorën elektrodën e ngurta. Për regjistrimin e lakoreve rrymë-potencial, elektroda duhet të jetë e polarizuar, gjë që arrihet me ushtrimin e vlerës së përshtatshme të potencialit mbi sipërfaqen e saj. Kjo bëhet nëpërmjet qarkut elektronik të quajtur potenciostat, duke përdorur celulën elektrokimike me tri elektroda (Fig. 2.4). Elektroda ndihmëse, pas elektrodës së punës, është elektroda e dytë në pajisjet me dy elektroda. Elektroda referuese është elektroda potenciali i të cilës është konstant, si dhe potenciali i të cilës është pikë referimi në pajisjet me tri elektroda. Elektroda e punës është elektrodë, rryma e të cilës është funksion i potencialit të aplikuar dhe përqendrimit të analitit.




Figura 2.4. Celula elektrokimike me sistemin tri elektroda.

Zgjedhja e materialit të elektrodës varet nga gjerësia e shtrirjes në rendin e potencialit të ushtruar, në vetitë e tretësisë, në kualitetin dhe pastërtinë e materialit. Rendi i potencialit që mund të ushtrohet në elektrodë është i kufizuar nga një apo më shumë faktorë, si dekompozimi i tretësisë, dekompozimi i elektrolitit bazë, oksidimi ose tretja e elektrodës apo formimi i shtresës inerte [70].

2.4.1 Voltametria ciklike

Voltametria ciklike është teknika më efektive dhe më e gjithanshme elektroanalitike që aplikohet për të studiuar mekanizmin e sistemeve redokse. Nëpërmjet përdorimit të kësaj teknike merret informacion i shpejtë për termodinamikën e proceseve redoks, kinetikën e reaksioneve heterogjene që shoqërohen me lëvizje elektronesh, reksionet kimike me mekanizëm si dhe për proceset e adsorbimit. Për këtë arsye çdo studim analitik që bazohet në procese elektronike, fillon zakonisht me eksperimentet e voltametrisë ciklike [90, 91].




Figura 2.5. Sinjali i ekscitimit potencial-kohë gjatë eksperimentit në voltmetri ciklike [92].

Kjo teknikë bazohet në ndryshimin (varirimin) e potencialit të aplikuar në elektrodën e punës në dy drejtime para dhe pas duke monitoruar rrymën (Fig.2.5). Analiza e rrymave gje gjegjëse ofron informacione të ndryshme për termodinamikën dhe kinetikën e transferit të elektroneve në shtresën elektrodë-elektrolit, për intermedierët e reaksioneve dhe stabilitetin e produkteve të reaksionit. [72].

Diagrami i paraqitur në figurën 2.5. mund të interpretohet në këto mënyra:

- Potenciali negativ paraqet skanimin nga +0.60 deri -0.40 V.
- Drejtimi i skanimit kthehet në potencialin -0.40 V.
- Potenciali pozitiv paraqet skanimin nga -0.40 deri +0.60 V.

Në të shumtën e rasteve skanimi i potencialit përfundon në fund të ciklit të parë (pika d), por mund të vazhdohet me skanimin e një numri më të madh të cikleve, prandaj edhe e quajmë të tillë. Vija me pika (vija e ndërpre) në figurën 2.5. paraqet ciklin e dytë. Një skanim në të cilën potenciali është gjithnjë pozitiv (p.sh. shkon në një drejtim pozitiv) është quajtur një skanim pozitiv. Skanimi në të cilën potenciali shkon duke u bërë gjithnjë e më negativ paraqet një skanim negative edhe pse potenciali aktualisht mund të jetë pozitiv ose gjatë gjithë kohës së skanimit, (siç është rasti në këtë shembull). Nëse koha e nevojshme për ciklin e parë është 10 s, shpejtësia e skanimit është $2V/10s$ ose $0.2 V/s$. Nga voltamogramet ciklik mund të fitohen parametra të rëndësishëm, prej të cilëve, piket e rrymave (i_{pc} , i_{pa}^*) dhe piket e potencialeve (E_{pc} , E_{pa}) janë shumë të rëndësishëm. Një voltamogram ciklik tipik për një çift redoks reversibël gjatë një cikli të potencialit është ilustruar në figurën 2.6. Një çift redoks në të cilët

me shpejtësi bëhet këmbimi i elektroneve me elektrodën e punës është quajtur qift elektrokimikisht i kthyeshëm. Qiftet e tilla mund të identifikohen me anë të regjistrimit të voltamogramit ciklik duke matur ndryshimin e dy pikëve të potencialeve. Ekuacioni 2.4 vlen për një sistem që është elektrokimikisht i kthyeshëm:

$$\Delta E_p = E_{pa} - E_{pc} \approx \frac{0.058}{n} \quad (2.4)$$

Ku n është numri i elektroneve të shkëmbyera dhe E_{pa} dhe E_{pc} janë potencialet kulmeve anodike dhe katodike, përkatësisht në volt. Vlera $0.058/n$ i ndan kulmet e potencialeve dhe është e pavarur nga shpejtësia e skanimit për një qift redoks, por lehtësisht varet numri i cikleve dhe kërcimeve të potencialeve [92].

Potenciali në mes dy kulmeve të potencialeve është potenciali formal i reduktimit për qiftin përkatës:

$$E^{\circ'} = \frac{E_{pa} + E_{pc}}{2} \quad (2.5)$$




Figura 2.6. Karakteristikat e një voltamogrami ciklik[92]

Në rastin kur reaksioni është plotësisht i kthyeshëm atëherë kemi:

$$E^{\circ'} = \frac{E_{pa} + E_{pc}}{2} \quad (2.6)$$

Në fund , piku i rrymës jepet me anë të :


$$i_p = 2.69 \times 10^5 n^{3/2} A D^{1/2} C v^{1/2} \quad (2.7)$$

ku n është numri i elektroneve, A sipërfaqja e elektrodës, D është koeficienti i difuzionit, C është përqendrimi dhe v shpejtësia e skanimit (e.g V/s) [90].

2.4.2 Amperometria hidrodinamike

Amperometria paraqet një degë të caktuar të metodave voltametrike në të cilën potenciali i ushtruar në elektrodën e punës mbahet konstant, potenciali i tillë mundëson transformimin e plotë elektrokimik të specieve oksido reduktuese. Në parim amperometria mund të aplikohet në tretësira statike (në kushte qetësie të tretësirës - pa përzierje, pa rrjedhje të tretësirës) dhe në tretësira dinamike (tretësira nën përzierje dhe sistemet nën rrjedhje [93]).

Që matjet amperometrike të jenë të shfrytëzueshme në mënyrë efektive është me rëndësi të potencohet se detektimi elektrokimik është teknikë sipërfaqësore, d.m.th. se analiti patjetër duhet bartur në sipërfaqe të elektrodës jo vetëm me anë të difuzionit por edhe me anë të konfeksionit. Metodatat që bazohen në transportin e masës me përzierje të reaktantëve dhe produkteve quhen metoda hidrodinamike, p.sh. teknikat që përfshijnë matjen e rrymave kufitare apo lakoreve rrymë-potencial njihen si voltametri hidrodinamike, ose amperometri



Në voltametri hidrodinamike parametri kohë është i bashkangjitur me rendin e përzierjes dhe është parametër kritik në ekzaminimin e kinetikës heterogjene dhe homogjene të lidhur (të asocuar) me mekanizmin e reaksionit në elektrodë. Kjo marrëdhënie luan rol analog me atë të rendit të skanimit në eksperiment të voltametrisë ciklike. Duke marrë sekuencat e mekanizmit ECE (ekuacioni 2.8), rëndësia e parametrin kohë mund të shihet duke ekzaminuar numrin efektiv të elektroneve të transferuara [72].

2.4.3. Amperometria te sistemet në rrjedhje FIA (Flow Injection Analysis)

Sistemi me analizë në rrjedhje kryesisht bazohet në injektimin e mostrës në një rrjedh të vazhdueshme në të cilën ndodhet bartësi i caktuar dhe i cili bartë mostrën deri tek detektori.




Figura 2.7. Skema e përgjithshme dhe pajisjet e sistemit të analizës me injektim në rrjedhje për detektim amperometrik.

Bartësi arrin të lëviz me anë të një pompe të caktuar, ndërsa detektori mund të jetë i natyrës së ndryshme (optike, elektrokimike etj.) në varësi se cila teknikë analitike përdoret. Sistemin me analizë në rrjedhje për herë të parë e kanë propozuar Ruzicka dhe Hansen në vitin 1947 dhe në formën më të thjeshtë të saj përbëhet nga një pompë, injektori dhe detektori. Në këtë lloj sistemi sinjali është paraqitur në formë të pikëve të mprehta me rritje të shpejtë dhe rënie të sinjalit të rrymës, duke reflektuar kalimin e shpejtë të analitit nëpër sipërfaqen e elektrodës së punës, Fig. 2.8 [93, 94].




Figura 2.8. Një shembull i një amperogrami hidrodinamik i fituar gjatë analizës me injektim në rrjedhje. FIA është një metodë e duhur për përcaktime të shpejta dhe për numër të madh mostrash për kohë të shpejtë; është një metodë ideale për testimin dhe optimizimin e kushteve analitike, automatizim i trajtimit të mostrave, kosto e ulët e analizës, dhe shumë shpesh po përdoret për hulumtime në biosensor [95].

2.2.4. Elektrodat

Elektrodat e ngurta në formë disku janë më të zakonshmet në voltametri, por gjithashtu mund të jenë edhe të formave të tjera (mund të jetë edhe një tel i thjeshtë) Figura 2.9, si materiale që përdoren për të ndërtuar elektrodat janë platini, ari, argjendi dhe lloje të ndryshme të karbonit si dhe amalgamë të ndryshme.




Figura 2.9 Disk elektroda e punës [92].

Elektrodat e karbonit janë shumë të gjithanshëm ngase me modifikimin e tyre mund të zgjerohen fushat e detektimit, elektrodat e merkurit zakonisht përdoren në potenciale shumë negative duke theksuar mbi potencialin shumë të lartë ndaj hidrogjenit, që elektrodat tjera nuk e kanë, në këtë mënyrë në elektrodë reduktohet specia që analizohet e jo hidrogjeni duke qar analizën në dështim. Megjithatë në tretësirat jo ujore dhe në potenciale pozitive preferohen elektrodat e ngurta në formë disku. Elektroda e punës duhet që në mënyrë sa më të lehtë të bëjë shkëmbimin e elektroneve me speciet elektroaktive. Elektroda duhet punuar në mënyrë sa më të mirë që të kemi rezultate të dëshiruara, kështu sipërfaqja të jetë sa më e lëmuar, të mos dëmtohet gjatë punës, kështu arrihet të kemi performancë më të mirë.

Elektroda shumë lehtë ndodh që të ndotët dhe shpeshherë duhet bërë lustrimi i sipërfaqes së saj. Efekteve të dëmshme të tilla si rënie IR (omike) dhe koha e ngarkesës në masë të madhe mund të reduktohen duke e zvogëluar sipërfaqen (radiusin) e elektrodës. Rezultate shumë të mira mund të arrihen duke përdorur ultra-mikroelektroda (radiusi $< 100\mu\text{m}$). Radiusi që përdoret më së shumti është rreth 0.2 cm [92].

Elektrodat nga karboni dhe modifikimi i tyre

Struktura sp^2 e karbonit është treguar të jetë shumë më e komplikuar se e metaleve fisnike si Pt, në këtë mënyrë nga kjo strukturë pritët të kemi sjellje më të ndryshme. Si pasojë e hibridizimit sp^2 karboni dallon shumë nga elementët tjerë si në përçueshmëri që e ka shumë të lartë, stabilitet, porozitet, dhe në qëndrueshmëri mekanike (është material i butë në formë pluhuri), etj. Duhet pasur kujdes llojin e materialit nga karboni dhe përgatitjen e tij për aplikime elektrokimike [92].



Figura 2.10. Procesi i përgatitjes së pastës së karbonit dhe vendosja e saj në piston

Përderisa kemi forma dhe modifikime alotropike të ndryshme të karbonit, kemi edhe elektroda të llojeve të caktuara nga ky material që dallojnë në dizajnë, sjellje elektrokimike, performancë analitike etj. Prej elektrodave më të përdorshme nga karboni i kemi elektrodën pastë karboni (CPE), elektrodën e printuar të karbonit në shtresë të hollë (SCPE), elektrodën nga karboni qelqor (GC) dhe elektrodën e diamantit e dopuar me bor (BDDE). Këto elektroda janë përdorur si sensorë elektrokimik dhe biosensorë për shkak të mundësisë së përdorimit të tyre në forma të ndryshme, për shkak të çmimit të ulët, intervalit mjaft të gjerë të vlerave të potencialit në të cilin mund të funksionojnë këto elektroda duke ofruar mundësi studimi më të gjerë, për shkak të rrymës bazë të ulët gjë që i bën më të përshtatshëm për matje. Gjithashtu ato janë kimikisht inerte dhe lehtësisht mund të modifikohen kimikisht. [92-93, 96]




Figura 2.11. Elektrodën të ndryshme nga karboni: A) Elektrodën e printuar në shtresë të hollë, B) Elektrodën nga karboni qelqor, C) Elektrodën e diamantit e dopuar me bor

Ideja fillestare për përgatitjen e elektrodave të pastës së karbonit është dhënë nga Adams në vitin 1958 i cili provonte për ta zëvendësuar elektrodën pikuese të merkurit me elektrodën pikuese të karbonit duke përdorur një raport të lartë të pjesës së lëngshme ndaj pjesës së ngurtë në mënyrë që materiali i karbonit të përngjaj merkurit pikues gjë e cila doli e papërshtatshme për një elektrodë hidrodinamike [97]. Në rendin e vlerave pozitive të potencialit elektrodën

mund të polarizohen deri në +1.4 V (vs. SCE), mirëpo me rritjen e pH te elektrolitit mbështetës, kjo do të ndikojë në kufirin e polarizimit. Gjithashtu edhe kufiri negativ varet nga pH e mjedisit të elektrolitit mbështetës, duke u radhitur nga -1.0 V në mjedis neutral deri në -1.5 në tretësira alkaline. Ky polarizim shkaktohet nga disa efekte, siç është adsorbimi dhe tretja e oksigjenit në pastën e karbonit, ose përmbajtja e grupeve të oksigjenit në sipërfaqen e elektrodës nga grimcat e karbonit.

Elektrodat pastë karboni (CPE) janë të përbëra nga pluhuri i grafitit dhe një lidhës i caktuar i cili mund të jetë vaj silikon ose parafine. Grafiti së bashku me materialin lidhës formojnë pastën e karbonit e cila lehtë mund të vendoset në një piston të caktuar (pipetë, piston nga lapsi kimik, ose piston i veçantë komercial i dedikuar enkas për këtë qëllim, etj.), në këtë mënyrë formohen elektrodat pastë karboni. Janë shumë praktike ngase ndërtohen lehtë, ekziston mundësia që ato të modifohen në brendi dhe sipërfaqe, janë përdorshme në metodat voltametrike, potenciometrike e kulonometrike.

Elektrodat e printuar të karbonit në shtresë të hollë (SCPE) mund të zhvillohet duke aplikuar materialin nga karboni në një pllakë të hollë me gjatësi disa cm e përbërë nga materiali inert (qeramikë, PVC, etj.). Zakonisht tash elektrodat e printuar të karbonit gjenden të gatshme në treg që lehtëson dhe shpejton punën hulumtuese në këtë drejtim. Kjo teknikë ka përparësitë e veta si: fleksibiliteti në dizajnim, automatizim të procesit, riprodhueshmëri të mirë, zgjedhje të materialeve të ndryshme dhe reduktim të shpenzimeve. E njëjta edhe parashihet si një metodë alternative për prodhim të sensorëve me kosto të ulët dhe sasi të madhe.

Elektrodat nga karboni qelqor mu d të përgatiten vete ose të blihen të gatshme. Këto elektroda karakterizohen me fortësi të lartë, duke ndikuar që absorbimi në sipërfaqe të elektrodës të jetë minimal e sidomos kur e krahasojmë me elektrodat pastë karboni. Me fortësi të lartë karakterizohet edhe elektroda e diamantit e dopuar me bor, por shumë herë më të lartë se elektroda paraprake. Kjo elektrodë mund të përdoret në potenciale shumë pozitive dhe gjithashtu edhe tek ato negative, absorbimi në sipërfaqen saj është jashtëzakonisht i vogël, ofron stabilitet të lartë (riprodhueshmëri të lartë) etj.

Në shumë raste elektrodat e pastra të karbonit nuk janë të aftë të prodhojnë sinjale specifike dhe selektive, sidomos për mostrat fiziologjike ke kemi prezencë të shumë substancave kimike të cilat interferojnë në matjet kimike. Për këtë arsye është e nevojshme që elektrodat në përgjithësi të modifikohen. Elektrodat e karbonit mund të modifikohen në brendi ose në sipërfaqe ndërsa natyra e modifikueseve mund të jetë inorganike ose organike, mund të përdoren edhe komponente biologjike në modifikimin e elektrodave duke prodhuar në këtë rast biosensorë. Si komponente të mundshme biologjike mund të jenë proteinat ose enzimat, polisaharidet ose acidet nukleike, organelet qelizore ose mund të jetë edhe e gjithë qeliza (mikroorganizmat) dhe indet e frutave etj. Procesi i modifikimit mund të jetë fizik ose kimik. Procesi fizik mund të realizohet diku e përzier në mënyrë të thjeshtë materialin nga karboni (pastën) me modifikues dhe më pas duke e homogjenizuar masën, procesi fizik mund të realizohet edhe në sipërfaqe të elektrodës me anë të absorbimit. Procesi elektrokimik realizohet në atë mënyrë që në elektrodën e punës ushtrohet potencial i caktuar i cili ndikon që sipërfaqja e elektrodës të mëveshët me shtresa të caktuara të modifikuesit ose të formohen grupe tjera të caktuara kimike.

Modifikuesit duhet të jenë të patretshëm në tretësirën të cilës i ekspozohen, apo të paktë ata duhet të jenë fuqishëm të absorbueshëm në thërmijat e karbonit, përndryshe mund të ketë rrjedhje nga struktura e pastës apo ngjyrës, duke dhënë rezultate të dobëta të riprodhueshmërisë.

Modifikimi do të jetë më i suksesshëm në përmirësimin e sinjalit sa më lipofilike që të jenë molekulat e modifikuesit. Modifikuesi nuk duhet të jetë elektroaktiv në zonën e potencialit të punës, përveçse nëse kërkohet të shfrytëzohen efektet e tij elektrokatalitike, ngase rrymat e larta të sfondit e përkeqësojnë apo dhe e dëmtojnë përgjigjen elektrokimike të sensorit. Modifikuesi mund të ketë efekt elektrokatalitik, ku përveç efektit të para përqendrimit, ai luan rol ndërmjetësues në procesin e shkëmbimit të elektroneve në mes të molekulave apo joneve me substratin [93].

2.2.5. Nanomaterialet nga karboni

Procedurat në elektroanalizë varen fuqishëm nga aspektet e materialit siç janë vetitë kimike dhe fizike të sipërfaqes së elektrodës, efekti i potencialit operues, adsorbimi dhe aplikimi i veshjeve në sipërfaqen e elektrodës për të rritur sinjalin analitik. Materialet nga karboni janë të përdorura gjerësisht në fushën e elektroanalitikës, për shkak të inertësisë kimike, puna në një potencial të gjerë operues, rrymë bazike të ulët dhe stabilitet të lartë për në analiza të ndryshme [98].

Grafeni është nga nanomaterialet të karbonit më të përdorshme në ditët e sotme i cili u zbulua në vitin 2004 nga K. S. Novoselov dhe A. K. Geim për çka në vitin 2010 morën çmimin Nobel. Zbulimi i grafenit ka pasur një ndikim të madh në fushën e shkencës dhe teknologjisë për shkak të vetive të tij interesante fizike dhe kimike. Grafeni posedon sipërfaqe të madhe specifike, fortësi të lartë, përçueshmëri të shkëlqyeshme elektrike dhe termike, veti të jashtëzakonshme elektronike dhe aftësi të bartjes së elektronit, jo përshkueshmëri dhe përkulshmëri të pashembullt [99]. Në aspektin e strukturës grafeni përbëhet nga një shtresë e vetme planare - dy dimensionale me trashësinë e një atomi, e cila përfshin një strukturë të karbonit me hibridizim sp^2 me kënd të lidhjeve 120° , të përbërë nga një numër i madh i strukturave policiklike, me cilësi jashtëzakonisht të larta elektronike dhe kristalore [100 101].




Figura 2.12. Disa materiale dhe nanomateriale nga karboni [102]

Interesi në nanotuba të karbonit (CNTs) vjen për shkak të stabilitetit kimik, dallimit në vetitë mekanike dhe elektronike. Këto përparësi janë produkt i strukturës kimike të tyre në krahasim me fibrat nga karboni tradicional dhe grafiti. CNTs posedojnë një strukturë cilindrike, e derivuar nga zbrazëtirat heksagonale.

CNTs konsistojnë në dy forma strukturore, nanotubat e karbonit një shtresor (SWCNTs) dhe nanotubat e karbonit shumë shtresor (MWCNTs)[103], [104]. SWCNTs janë të ndërtuara nga “gypa” të grafitit me diametër 1-2 nm nga një shtresë individuale e grafitit në formë cilindrike, ndërsa MWNTs përbëhen nga shumë shtresa individuale të grafitit me diameter nga 2-100 nm, ku hapësira është në mes “gypave” sillet rreth 25 nm [105].

Për më tepër, kur CNTs përdoren si material për elektroda gjatë matjeve elektrokimike, ofrojnë aftësi të transferojnë elektronet shpejtë [106], posedojnë potencial të lartë si biosensor për shkak të mundësisë për ti mobilizuar lehtë proteinat e caktuar [107], [108].

PJESA EKSPERIMENTALE

3. MATERIALI DHE METODAT

3.1 Reagentët kimik

Acetaminofen, N,N-dimetil formamidë(DMF), metanol $\geq 99.9\%$ gradë të HPLC, 25% glutaraldehyd (GTA), 5% Nafion[®] në 55% etanol, acid hialaronik kripë e natriumit (30-50 kDa nga *Streptococcus equi*, qitosan, (~50 kDa) dhe pluhur të kërpudhave (*Agricus bisporus*) tirozinazë (EC 1.14.18.1) (119.5 kDa duke përdorur elektroforezën blerë nga Sigma-Aldrich (Pragë, Republika Çeke). Grafen i pafunksionalizuar një shtresorë (NFG) (me rezistencë $\leq 0.30 \Omega \text{ cm}$; sipërfaqe specifike $400\text{-}1000 \text{ m}^2 \text{ g}^{-1}$) marr nga CS Material, LLC (Medford, USA). Nanotuba shumë shtresor të karbonit (MWCNTs) me diametër 10-30 nm, gjatësi 5-15 μm , sipërfaqe specifike $10\text{-}300 \text{ m}^2 \text{ g}^{-1}$, dhe nanotuba një shtresor (SWCNTs) me diametër $< 10 \text{ nm}$, gjatësi 5-15 μm , sipërfaqe specifike $> 400 \text{ m}^2 \text{ g}^{-1}$, marr nga Shenzen Nanotech Port Co., Ltd. (Shenzen Kinë). Grafit spektroskopik (diametër mesatar të gramcave prej 2 μm) nga Graphite Tyn s. O., Tyn nad Vltavou, Rep. Çeke, vaj parafine për spektroskopi nga Merck, Darmstadt, Gjermani. Standarde në garadë analitike të L-acid askorbik, acid kafeik, kofeinë, trans-acid cinamik, (-)-epikatekinë, (\pm)-6-hidroksi-2,5,7,8-tetrametilkroman-2-karboksilik acid (Troloks), 1,1 difenil-2-pikrilhidrazil radikal, acid klorogjenik, acid gallik, kamferol, hidrat i katekinës, naringinë, sinapik acid, theobrominë dhe vanilinë, të gjitha nga Sigma Aldrich (Pragë, Republika Çeke). Ujë i distiluar (rezistenca $> 18 \text{ M}\Omega \text{ cm}$) përgatitur nga sistemi i pastrimit Milli-Q nga Merck Millipore (Burlington, SHBA). Kemikatet për përgatitjen e pufirit fosfat (PB) janë marr nga Lach-Ner s.r.o. (Neratovice, Republika Çeke).

3.2 Llojet e elektrodave të përdorura

Kryesisht janë përdorur elektroda me bazë karboni, si grafit, grafen, diamant, dhe karbon qelqor. Elektrodat me pastë karboni (grafiti) janë përgatitur vetë, ku fillimisht janë marr 0.500g grafit pluhur dhe 0.125 g vaj parafine. Më pas kjo masë është homogjenizuar në një havan porcelani për 30 min. Pas homogjenizimit pasta ka qëndruar për 24h dhe më pas është bërë e gatshme për përdorim. Në fund pasta vendoset në piston të caktuar dhe në fund bëhet rrafshimi i sipërfaqes ku zakonisht realizohet duke ushtruar presion në formë rrethore mbi një letër filtruese me diametër 3 mm [19]. Matja e rezistencës omike të elektrodës së përgatitur ka qenë 20Ω maksimum, që korrespondon edhe vlerat tjera të publikuara [20].




Figura 3.1 A) Pasta e karbonit e përgatitur dhe B) Procesi i vendosjes së pastës në piston

Elektrodat e printuara me të cilat është zhvilluar pjesë kryesore e hulumtimit janë përdorur zakonisht të freskëta dhe nuk ka pasur nevojë për ndonjë trajtim paraprak. Këto elektroda kanë

qenë të llojit DropSens (DS 150) nga prodhuesi Metrohm e që në vetvete përmbajnë të inkuadruara tri llojet e elektrodave, atë të punës (grafit), referente (argjend) dhe elektrodën ndihmëse (platin), ku gjithashtu nevojitet lidhëse veçantë me potenciostat.




Figura 3.2 Elektroda e komerciale e printuar e llojit DS-150

Janë përdorur edhe elektrodën e gatshme të cilat kanë sipërfaqe të forta siç është elektroda e diamantit dhe ajo e karbonit qelqor. Këto elektrodë para përdorimit i nënshtrohen polirimit mbi suspensionin e grimcave të oksidës së aluminit dhe më pas shpërlahen me ujë të distiluar dhe acetone.




Figura 3.3 Elektroda nga karboni qelqor (A), dhe elektroda e diamantit e dopuar me bor (B)

Si elektrodë referente në rastin e përdorimit të biosensorit elektrokimik nga elektroda pastë karboni ka qenë elektroda $\text{Ag}/\text{AgCl}/ 3.0 \text{ M KCl}$ ndërsa teli i platinës ka shërbyer si elektrodë ndihmëse. Mini elektroda referente $\text{Ag}/\text{AgCl}/ 3.0\text{M NaCl}$ është përdorur në rastin e analizës së ekstrakteve të çokollatës së dhe gjithashtu elektrodë ndihmëse ka qenë teli i platinës. Matjet kinetike që kanë konsistuar përdorimin e komplekseve të bakrit për parë mundësin nëse mund të bëhet zëvendësimi i enzimës, janë realizuar duke e përdorur elektrodën referente të kalomelit $\text{Hg}/\text{Hg}_2\text{Cl}_2/ \text{KCl}$ i ngopur, duke përdorur urën elektrolitike të LiClO_4 0.1M në metanol absolut. Edhe elektroda nga platini ka shërbyer si elektrodë ndihmëse.

3.3 Përgatitja e biosensorëve elektrokimik

Për përgatitjen e biosensorëve elektrokimik janë përdorur dy lloje të elektrodave, ato të printuara të tipi DS-150 dhe elektrodave të karbonit. Modifikimi i këtyre elektrodave është shumë i ngjashëm ngase dallimi i vetëm pothuajse është përdorimi i nanomaterialeve të ndryshme nga karboni.

Elektrodave të llojit DS-150 janë modifikuar duke përdorur disa faza. Në fazën e parë elektrodave janë modifikuar me materiale të karbonit si grafen duke aplikuar 20µL grafen ose nanotubave të karbonit në sipërfaqen e elektrodës të disperguara në N,N-dimetil formamidë (DMF) me përqendrim 2 mg mL⁻¹ ku paraprakisht janë vendosur në banjo ultrasonike për 20min. Pas aplikimit të grafenit ose nanotubave të karbonit elektroda ka qëndruar 24h në mënyrë që të bëhet tharja e plotë në kusht laboratorike. Aplikimi i enzimës në sipërfaqe të elektrodës është realizuar në tri faza. Fillimisht janë shtuar 5µL enzimë në formë të tretësirës me përqendrim 2 mg mL⁻¹ në puffer fosfat dhe më pas ka qëndruar për 30 min për tu thar në kushte laboratorike.




Figura 3.4 Procesi i modifikimit të elektrodës së punës të tipit DS-150

Pasi që është bërë adsorbimi i enzimës në shtresën e hollë të grafenit, është bërë lidhja e molekulave të enzimës mes vete duke përdorur glutaraldehyd 1% në sasi prej 3 µL, koha për tharje të kësaj faze ka qenë 20 min. Në fund fare janë shtuar 10 µL Nafion i cili është një polimer duke luajtur rolin e një rrjete në mënyrë që mos të largohen molekulat e enzimës nga elektroda [30].




Figura 3.5. Pamja e elektrodave të punës gjatë procesit të modifikimit. A) elektroda e printuar, B) elektroda pastë karboni

Në rastin e elektrodave pastë karboni procedura e modifikimit pak ka dalluar. Edhe këtu fillimisht është bërë modifikimi i elektrodës me nanomateriale të karbonit (nanotuba të karbonit shumë shtresor) duke aplikuar në sipërfaqe të elektrodës $20 \mu\text{L}$ me përqendrim 2 mg mL^{-1} . Dallimi kryesor qëndron në formën se i është vendosur enzima tek kjo elektrodë. Fillimisht është përgatitur një përzierje që ka përmbajtur $40 \mu\text{L}$ Nafion, $60 \mu\text{L}$ ujë i ridistiluar dhe $150 \mu\text{L}$ tretësirë të enzimes me përqendrim $500 \mu\text{g} \cdot \text{mL}^{-1}$. Sasi prej $10 \mu\text{L}$ nga tretësira e përgatitur është vendosur në sipërfaqen e elektrodës pastë karboni në të cilën paraprakisht është vendosur

shtresa e nanotubave të karbonit. Në fund sipërfaqja e elektrodës është tharë në kushte laboratorike. Nëse nuk është përdorur është vendosur në frigorifer në temperaturë prej 5°C [21].

3.4 Aparatuara e përdorur

Matjet elektrokimike janë realizuar duke përdorur potenciostatin/galvanostatin AUTOLAB i llojit PGSTAT 101 operuar me softuer NOVA 1.11 nga Metrohm (Pragë, Rep. Çeke), (Fig. 3.6) dhe potenciostatin EmStat (PalmSens, Holandë) i kontrolluar përmes softuerit PStace 5.8. Sistemi me analizë në rrjedhje ka përbajtur pompën perisaltike shumë kanalësh MINIPLUS 3 nga Gilson(Middleton, SHBA), sistem automatik i injektimit me valvula gjashtë pozicionale nga INDEX Health & Science (Wertheim; Gjermani).



Figura 3.6 . Potenciostati/galvanostatin AUTOLAB medel PGSTAT 101

Matjet në sistemin me analizë në rrjedhje janë përdorur dy loje të celulave elektrokimike, e para e nga DropSens (Llanera, Spanjë), figura 3.7 A, tipike për përdorimin e elektrodave DS-150, dhe celula e cila bënë të mundur inkuadrimin e elektrodave më të mëdha siç është ajo e diamantit nga Inventek Sp. z o.o. (Varshavë, Poloni) figura 3.7 B. Tharës (Memmert, Schwabach, Gjermani) Helios Delta UV-VIS spektrofotometër (Thermo Ficher Scientific, Waltham, MA, SHBA). Fotografitë e sipërfaqeve të elektrodave janë fituar duke përdorura mikroskopin me skanim elektronik (SEM) JEOL JSM7500F (Tokio, Japoni). Aparaturë kromatografike me presion të lartë me sistem LC-20ADXR, sistem i degazimit DGU-20, SPD-M30A DAD, SIL-20 AC XR auto injektues (të gjitha Shimadzu, Kyoto, Japoni) dhe kolon kromatografike 102 LCO (Ecom, Pragë).




Figura 3.7 . (A) Celula elektrokimike nga DropSens, dhe (B) celula elektrokimike Inventek Sp. z o.o

Gjatë punës laboratorike janë përdorur edhe pajisje të rregullta si kompjuteri, peshore analitike, pH metër, centrifugë, banjo ultrasonike, mikropipeta automatike, përzierës, etj.



Figura 3.8 Mikroskopin me skanim elektronik (SEM) JEOL JSM7500F

3.5 Përgatitja e mostrave për analizë

Sensorët dhe biosensorët elektrokimik janë testuar duke përdorur 3 mostra, secila për sensorin e caktuar. Biosensori elektrokimik i cili është zhvilluar duke përdorur elektrodën e printuara DS-150 është testuar duke përdorur urinë dhe tableta të ndryshme farmaceutike. Biosensori elektrokimik nga pasta e karbonit është testuar duke përdorur fruta mali të ndryshme dhe sensorin elektrokimik nga elektroda e diamantit e dopuar me bor është testuar për të analizuar sasinë totale të polifenoleve në çokolata të ndryshme.

Tabletat Paralen[®] 500 dhe Telex[®] 750 të marra nga barnatoret në Rep. Çeke janë tretur në enë normale prej 250 mL duke përdorur puferin fosfat në rastin kur është bërë analiza amperometrike ose 80% metanol kur është bërë analiza referente me kromatografi të lëngët me presion të lartë (HPLC). Më pas tretësirat janë filtruar përdorur shiringë filter nga politetrafluoretileni me madhësi të poreve prej 0.45 µm, në fund është holluar për 20 herë duke përdorur ujin e ridistiluar.

Urinë normale e njeriut komerciale (50 mL) është blerë nga Inovative Research, Inc. (Novi, USA) shpërndarë nga Dvbio Science Europe (Ulvenhout, Holandë). Gjithashtu mostër e urinës është marrë nga një vullnetar i shëndetshëm i cili ka nënshkruar marrëveshjen e pëlqimit. Te dyja mostrat e urinës janë pasuruar në mënyrë artificiale me sasi të njohur të analitit (paracetamol) dhe kanë shërbyer si matriks kompleks. Të gjitha analizat e mostrave të urinës janë bërë sipas WMA Deklaratës së Helsinkit, Qershor 1964.

Vëllim prej 250 µL nga tretësira standarde e paracetamolit me përqendrim 0.01 M është pipetuar në enë normale prej 50 mL dhe me Pas është mbushur me urinë deri në shenjë. Në varësi të personit sa i përket statusit acido-bazik, vlera e pH e urinës sillet nga 4.5 – 8. Si rezultat vlerave të ndryshme të pH dhe sasia e lartë e kripshmërisë, mostra e urinës e përgatitur në këtë mënyrë është dashur të hollohet 5 herë duke përdorur pufer fosfat dhe më pas duke e filtruar përmes filtrit me diametër 0.45 µm i cili është përshkruar më lartë.

Për analizë me HPLC mostra e urinës së cilës iu është shtuar sasi e njohur e paracetamolit është përgatitur sipas procedurave të raportuara [27, 28] me një ndryshim shumë të vogël, ngase gjatë optimizimit është gjetur që acetonirila mundet plotësisht të zëvendësohet me metanol. Mostra me urinë të njeriut (0.5 mL) me 4 mL metanol të pastërt është vendosur në enë normale prej 10 mL. Për të arritur vlera pH 8 janë shtuar disa pika NaOH 1 M dhe më pas ena është nivelizuar deri në 10 mL duke përdorur ujin ultra të pastërtë. Kjo përzierje është centrifiguar në 5000 rpm për 3 min, filtruar dhe më pas është injektuar në kolonën kromatografike.

Biosensori elektrokimik bazuar në elektrodën e pastë karboni modifikuar me tirozinazë është testuar në përcaktimin e kapacitetit antioksidues në fruta mali të ndryshme duke përfshirë 5 lloje të tyre: manaferra *Rubus fruticosus*, boronicë *Vaccinium corymbosum*, boronicë e kuqe *Vaccinium erythrocarpum*, mjedër *Rubus idaeus* dhe dredhëza *Flagaria magna* marrë në marketet lokale. Përafërsisht 40 g të secilës frutë janë marrë dhe janë tharë fillimisht deri në peshë konstante, ku më pas janë imtësuar në havan porcelani për 20 min. Temperatura optimale e tharjes është sjellë nga 40 °C deri në 60 °C nga 3 deri në 5 ditë [22]. Nga 2 g fruta të imtësuar janë transferuar në një enë normale prej 50 mL dhe është mbushur deri në shenjë me tretësirë të etanolit 50% ku më pas është vendosur në banjo ultrasonike prej 60 min. Në fund mostrat janë filtruar me letra të thjeshta filtri, duhet theksuar faktin se tek dredhëzat është dashur të përdoret filtrimi me vakum për shkak të përmbajtjes së sasive të larta të patretshme që ka shkaktuar mbylljen e poreve të filtrit.



Figura 3.9. Ekstrakte e frutave pas procesit të filtrimit

Elektroda e diamantit e dopuar me bor është e fundit që është testuar në analizimin e mostrave reale dhe atë të çokolatës për të përcaktuar sasi të totale antioksiduese ekuivalent me troloksin. Si burim potencial i antioksidantëve janë marr disa çokollata me sasisë nga 0 deri në 80% (ë/ë) të kakaos të blera në marketet lokale në Prishtinë, Kosovë. 5 gram të këtij produkti janë ekstraktuar me 50 mL tretësirë e cila përmban ujë të distiluar aceton dhe acid acetik (70+29.8+0.2, v/v/v). Ekstraktimi është zhvilluar në banjo ultrasonike për 30 min. në temperaturë 30 °C . Acetoni është avulluar gjithashtu duke e përdorur banjone ultrasonike për 20 min. në temperaturë 40 °C. Pas ekstraktimit përbërja është neutralizuar me NaOH 0.1M deri në pH = 5.0 dhe më pas është bartur në enë normale prej 100mL duke e nivelizuar me pufër fosfat në 30 % (v/v) metanol. Në fund është bërë procesi i centrifugimit në 1000 rpm për 4 min dhe filtrati është centrifuguar dhe më pas supernatanti është filtruar ku diametri i vrimave të filtri ka qenë 1 µm. Filtrati nga ekstrakti i çokollatave është holluar për 5 herë për të reduktuar agjentët reduktues. Sasi e injektimit në sistemin me analizë në rrjedhje ka qenë 100 µL.




Figura 3.10. Procesi i filtrimit për tretësirën e çokollatës

Të gjitha analizat e përzgjedhura janë përsëritura 5 herë dhe rezultatet finale janë prezantuar në intervale të besueshmërisë $\bar{x} \pm st_{1-\alpha}$, ku \bar{x} është mesatarja aritmetike, s devijimi standard dhe $t_{1-\alpha}$ vlerat kritike të shpërndarjes së Studentit t (2.015) për numrin e dhënë të përcaktimeve në shkallë të besueshmërisë α prej 0.05 (95% të probabilitetit).

3.6 Procedura e punës dhe metodat e studimit

Tek të gjitha matjet eksperimentale metoda fillestare e studimit ka qenë voltametria ciklike me anë të së cilës janë analizuar efektet e modifikimit të sipërfaqeve të elektrodave, sjellja elektrokimike e analitëve etj. Amperometria hidrodinamike ka mundësuar të përcaktohen parametrat të cilat e diktojnë performancën e sensorit si potenciali operues, sasia e modifikuesit, shpejtësia e përzierjes, shpejtësia e rrjedhjes në rastin kur përdorim analizën me injektim në rrjedhje, rendin linear, kufirin e detektimit, informacione kinetike etj.

Gjatë matjeve eksperimentale me paracetamol është përdorur puferi fosfat 0.1M me pH prej 7.0 për shkak të efektit optimal katalitik për tirozinazën. Karakterizimi i biosensorit të zhvilluar më pas është bërë duke përdorur voltametrinë ciklike me përqendrim të paracetomolit 500 μM , shpejtësi të skanimit 10 $\text{mV}\cdot\text{s}^{-1}$, potencial të skanimit nga -0.2 V deri +0.8 V, potencial fillestar 0 V, kërcimi i potencialit 5 $\text{mV}\cdot\text{s}^{-1}$. Matjet amperometrike në sistemin me analizë në rrjedhje janë zhvilluar në potencial 0 V, shpejtësi të skanimit 0.6 mL min^{-1} . Puferi fosfat 0.01 M, pH

7.0 është përdorur edhe gjatë analizimit të sasive totale antioksiduese me elektrodën e llojit pastë karboni si biosensor elektrokimik. Studimet me voltometri ciklike janë zhvilluar duke përdorur potencial të skanimit fillestar 0 V nga -0.5 V deri në +1.3 V, kërcimi i potencialit $5 \text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$, shpejtësi të skanimit $10 \text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$. Amperometria hidrodinamike është aplikuar duke përdorur potencial -0.25 V, shpejtësi të përzierjes 400 rpm. Testimet eksperimentale me elektrodën e diamantit janë zhvilluar në vëllim prej 10 mL në pufer fosfat $0.1 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$ pH = 7.00, voltamogrami ciklik është skanuar duke filluar nga potenciali -0.4 V deri në potencialin +1.6 V, potenciali fillestar 0 V, kërcimi i potencialit 2.5 mV/ s , degazimi i tretësirës është bërë duke gurgulluar azot në tretësirë. Shpejtësia e skanimit ka qenë 50 mV/ s . Në amperometrinë hidrodinamike studimi është bërë duke imponuar potencial konstant tek elektroda e punës ndaj elektrodës referente. Potencialet në të cilat është bërë studimi kanë qenë nga +0.6 -+1.5 V. Pas matjeve janë ndërtuar lakoret e kalibrimit dhe është përzgjedhur rendi dinamik i përqendrimit ndaj sinjalit analitik. Gjithashtu me metodën e amperometrisë hidrodinamike është bërë edhe analiza e mostrave reale. Amperometria hidrodinamike është aplikuar duke sistemin me injektim në rrjedhje (FIA). Përndryshe për çdo ndryshim rreth kushteve të punës është përshkruar në secilën figurë të legjenda përkatëse.

3.6.1 Metodat referente për analizimin e mostrave reale

Për analizimin e mostrave reale janë përdorur edhe metoda analitike tjera referente në mënyrë që të sigurohet se performancë e sensorëve dhe biosensorëve është në rregull. Kromatografia e lëngët me presion të lartë është përzgjedhur si metodë referente për analizimin e paracetomolit. Performancë maksimale duke përdorur këtë metodë është arritur me anë të përdorimit të kolonës Ascentis Express C18 (150 mm x 3.0 mm, $2.7 \mu\text{m}$). Gjatësia valore e detektimit ka qenë 243 nm. Ndarja është realizuar duke përdorur fazën mobile e përbërë nga 0.3% acid formik në ujë (A) dhe metanol (B) me program të gradientit nga 20% deri në 40% B për 10 min në temperaturë konstante 30°C . Shpejtësia e rrjedhjes ka qenë 0.5 mL min^{-1} , vëllimi i injektimit $5 \mu\text{L}$. Për analizimin e polifenoleve në fruta është përdorur metoda shumë e popullarizuar e njohur si 1,1 difenil-2-pikrilhidrazil radikal (DPPH). Analizë e mostrave të frutave me këtë metodë është realizuar duke transferuar $100 \mu\text{L}$ të ekstrakteve alkoolike të frutave në 5.0 mL DPPH me përqendrim $25 \mu\text{g/mL}$, dhe më pas është matur absorbancë në 515 nm. Kuptohet që paraprakisht janë përgatitur standardet duke përdorur troloksin. Tek analiza çokollatave nuk kemi përdorur metodë referente ngase jemi shërbyer me vlerat e deklaruara të kakaos në çokollata ku më pas është bërë krahasimi nëse vlerat i korrespondojnë sasive të deklaruara.

4. REZULTATET DHE DISKUTIMET

4.1. Karakterizimi elektrokimik dhe performanca analitike e biosensorit elektrokimik bazuar në elektrodën e printuar për përcaktimin e paracetamolit

Objekti kryesor i këtij studimi ka qenë zhvillimi i një sensori me selektivitet dhe sensitivitet të lartë i cili mund të përdoret në mënyrë universale në analiza të ndryshme farmaceutike dhe klinike. Në përgjithësi, disa kushte duhet të plotësohen. Biosensori duhet të jetë i aftë të përcaktojë përmbajtje shumë të ulët të analitit dhe të ofrojë përgjigje stabile për një kohë shumë të gjatë(i). Substancat tjera jashtë analitit nuk duhet të pengojnë sa më pak tek sinjali analitik (ii). Nëse është e mundur, ata duhet të prodhohen me kosto sa më të ulët(iii). Për sensorët amperometrik, është e nevojshme që elementi bionjohës (tirozinaza) të jetë më aftër shëndërruesit elektrokimik(elektrodës) që zakonisht është i modifikuar me substanca me sipërfaqe të madhe specifike dhe me përmbajtje katalitike. Siç u përmend më lartë, sipërfaqja e elektrodës duhet të jetë sa më e madhe [109, 110].




Figura 4.1 Voltamogrami ciklik i APAP me përqendrim $0.5 \text{ mmol} \cdot \text{L}^{-1}$ të elektroda e pamodifikuar SPCE(vija plotë), SPCE/MWCNT (vija e ndërprerë), dhe SPCE/NFG(vija me pika) realizuar në puferin fosfat $0.1 \text{ mol} \cdot \text{L}^{-1}$ pH 7.0, shpejtësi të skanimimit $10 \text{ mV} \cdot \text{s}^{-1}$

Tabela 4.1. Sjellja elektrokimike e paracetamolit në shëndërrues të ndryshëm amperometrik

| Sensori | E_p^a (mV) | E_{pc} (mV) | I_p^a (μ A) | I_p^c (μ A) | $\Delta E_p(E_p^a - E_p^c)$ | $ I_p^a/I_p^c $ |
|--------------------|--------------|---------------|--------------------|--------------------|-----------------------------|-----------------|
| SPCE | 0.384 | 0.021 | 8.447 | 1.760 | 0.363 | 4.801 |
| SCOE/NFG | 0.378 | 0.323 | 24.742 | 6.380 | 0.055 | 3.878 |
| SPCE/SWCNTs | 0.338 | 0.152 | 13.584 | 5.642 | 0.186 | 2.408 |
| SPCE/MWCNTs | 0.339 | 0.151 | 13.571 | 5.613 | 0.187 | 2.418 |

Rezultatet me anë të voltametrisë ciklike për APAP me përqendrim 0.5 mmol L^{-1} në puferin fosfat $0.1 \text{ mol} \cdot \text{L}^{-1}$ pH 7.0, shpejtësi të skanimit $10 \text{ mV} \cdot \text{s}^{-1}$.

Sipërfaqja e SPCEs është modifikuar me lloje të ndryshme të nanomaterialve të pa funksionalizuara të karbonit (CNs) për të fituar shëndërruesin amperometrik më idealin. Voltametria ciklike ka treguar që APAP ofron sjellje shumë më të mirë tek elektroda e llojit SPCE/NFG se sa në rastin e përdorimit të nanotubave të karbonit (CNTs), Figura 4.1.

Një sqarim për këtë ndryshim mund gjendet duke i krahasuar homogjenitetin e secilës sipërfaqe të këtyre nanomaterialve që varet nga rregullimi i CNs të përdorura. Vendosja e CNTs formon forma të parregullta me madhësi të ndryshme dhe janë ndërlidhura së bashku ku në një far mënyre e bllokojnë sipërfaqet aktive. Për këtë arsye sipërfaqja komplete aktive nuk mundet komplet të shfrytëzohet si në rastin e NFG që formojnë një strukturë pëlhure të trashë, sigurisht për shkak të bashkëveprimit të shtresave planare të grafenit [111, 112]. Në përgjithësi sipërfaqja është e karakterizuar me homogjenitet më të lartë se në rastin e CNTs. Për vendosje më efektive të enzimës (tirozinazës), janë testuar tre materiale polimerike të zakonshme: kitosani, acidi hialuronik në formë të kripës së natriumit dhe Nafioni®. Prezenca e kitosanit dhe acidit Hialuronik ka shkaktuar që të rritet për shumë herë rryma bazike se në rastin e përdorimit të nafionit. Për këtë arsye Nafioni® është përzgjedhur si materiali më i mirë polimerik për ta inkorporuar enzimën në sipërfaqe të elektrodës. Glutaraldehidi është përdorur për lidhur mes vete enzimës [113], dhe është parë që me shtimin e më shumë se $3 \mu\text{L}$ të tretësirës 1% shkakton rritje të shpejtë të rrymës bazike dhe zbret sinjali analitik në formë të rrymës elektrike.

Në mënyrë për ta parë elektrodën më të përshtatshme të punës, sjelljen elektrokimike të paracetamolit, studimi është bërë duke e përdorur voltametrinë ciklike. Nuk është vërtetuar ndonjë ndryshim i madh në mes të MCNTs dhe SWCNTs, Tabela 6.1. Figura 4.2 paraqet voltamogramet ciklike të fituara në rastet kur është përdorur SPCE, SPCE/NFG, dhe biosensori.




Figura 4.2. Voltamogrami ciklik i APAP me përqendrim $0.5\text{mmol}\cdot\text{L}^{-1}$ të elektroda e modifikuar me grafen (vija e ndërprerë), dhe elektroda e modifikuar me grafen dhe tirozinazë (vija me pika) realizuar në puferin fosfat $0.1\text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$ pH 7.0, shpejtësi të skanimit $10\text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$

Paracetamoli i nënshtrohet reaksioneve të hidrosilimit në pozitën e lirë orto ku formohet produkti oksidues i mëvonshëm 4-acetamido-o-benzokinon (4-AOBQ) [13]. Kjo është rruga tipike e oksidimit elektrokimik të zëvendësuesve para të fenolëve kur përdoren elektrodën pastë karboni [14]. Reaksioni i sipërpërmendur i hidrosilimit dhe oksidimi i mëvonshëm i 4-acetamido-1,2-katekolit (3-OH-APAP) është dominues në prani të enzimës tirozinazë (EC 1.14.18.1) nga kërpudha *Agaricus bisporus* e cila katalizon këto procese oksidimi nga oksigjeni i tretur për shkak të aktivitetit të kresolazës dhe katekolazës (Fig. 4.3), ku produktet përfundimtare janë 4-AOBQ dhe uji. Për shkak të selektivitetit të biosensorit, ka qenë e rëndësishme që rryma katodike e reduktimit të 4-AOBQ të fillojë në potencial të lartë (+0.146 V) me sinjal maksimal të rrymës elektrike në potencialin (+0.04 V) ndaj pseudo-elektrodës referente Ag/AgCl (figura 4.1). Rrjedhimisht, përcaktimi amperometrik në potencialin konstant operues 0 V mund të përzgjidhet për përcaktimin e 4-AOBQ.




Figura 4.3 Efekti katalitik dhe oksidimi i paracetamolit nga tirozinaza.

4.1.1 Efekti i shpejtësisë së rrjedhjes në sistemin me analizë në rrjedhje

Shpejtësia e rrjedhjes parqet një prej faktorëve të rëndësishëm në sistemin me analizë në rrjedhje (FIA), ngase definon kohën për të cilën APAP qëndron në celulë në të cilën ndodh reaksioni kimik. Matjet janë realizuar në potencial $-0.1V$, shpejtësia e rrjedhjes është studiuar nga 0.2 deri $2.0 \text{ mL} \cdot \text{min}^{-1}$ me përqendrim të APAP $50 \mu\text{mol} \cdot \text{L}^{-1}$. Gjetjet kanë treguar që shpejtësia e rrjedhjes deri në $0.6 \text{ mL} \cdot \text{min}^{-1}$ sinjali ka shkuar duke u rritur dhe më pas ka rënë gradualisht. Rrjedhimisht shpejtësia e rrjedhjes $0.6 \text{ mL} \cdot \text{min}^{-1}$ është zgjedhur si optimale (Figura 4.4)




Figura 4.4. Efekti i shpejtësisë së rrjedhjes

4.1.2 Efekti i potencialit operues

Meqenëse potenciali operues duhet të mbahet konstant gjatë analizës, paraqet rolin kryesor në aplikimin amperometrik tek biosensorët [114]. Ky parametër thembësor ndikon në selektivitetin dhe sensitivitetin e metodës [115]. Efekti i aplikimit të potencialeve në vlera nga 0 deri në -0.3 V është studiuar në rast.




Figura 4.5 Efekti i potencialit operues. Elektroliti mbështetës puferi fosfat 0.1, pH = 7.0, vëllimi i injektimit 100 µL, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min⁻¹ dhe temperatura: 25°C.

Figura 4.5 tregon se në potencialet më të ulëta se -0.15 V nuk kemi ndonjë ngritje statistikisht të rëndësishme të sinjalit analitik. Për më tepër, është gjetur se rryma bazike rritet dukshëm në vlerat e potencialeve më të ulëta se -0.2 V. Prandaj mund të përfundohet se vlera -0.15 V është potenciali operues optimal. Kjo vlerë e potencialit mund të përdoret për përcaktimin e APAP në formulime farmaceutike, ngase këto formulim nuk përmbajnë substanca që interferojnë




Figura 4.6 Amperogramet e fituara në systemin FIA gjatë pesë injektiveve të tretësirës së holluar të urines(zi) dhe tretësirës cila përmban $50 \mu \text{ mol L}^{-1}$ APAP (kuq), në potencialle të ndryshme të punës. Elektroliti mbështetës puferi fosfat 0.1, pH = 7.0, vëllimi i injektimit $100 \mu \text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

dukshëm në matjet analitike siç janë amidoni, acidi stearik, Povidone K-30 (polivinilpirrolidon, PVP), kroskarmelozë e natriumit.. Megjithatë ky potencial operues nuk mund të aplikohet për mostrat e urinës ngase në këto mostra kemi matriks shumë kompleks.

Për ta përcaktuar potencialin operues optimal për analizimin e mostrave të urinës është marruar mostër e tillë dhe është shtuar paracetamol me përqendrim $50 \mu \text{ mol L}^{-1}$ (vija e kuqe).

Ky përqendrim nuk është përzgjedhur rastësisht ngase marrim APAP nga tabletat 500 mg, duke llogaritur se 2% e kësaj mase nuk ndryshon në gjatë qëndrimit në organizëm mund të pritët që kjo masë në urinë të ketë përqendrim $\sim 50 \mu \text{ mol}$ për litër [116]. Vetë urina ofron sinjal të rrem për shkak të reduktimit elektrokimik të metabolitëve elektroaktiv ne urinë (vija e zezë). Ky lloj sinjali rritet duke e me rritjen e potencialit operues në vlera negative siç paraqitur në Fig. 4.7. Vetën në potencial 0 V përgjigjja e rrymës në urinën e pastër nuk ka qenë me e lartë se sa devijimi standard i pesë matjeve të përsëritura të urinës me shtesë të paracetamolit (Fig. 4.7). Për këtë arsye potenciali operues 0 V është përzgjedhur si optimali për ta përcaktuar paracetamolnë në mostër të urinës.




Figura 4.7 Sinjali amperometrik për urinën e pastër (kaltër) dhe urinën me $50 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ paracetamol (verdhtë). Elektroliti mbështetës puferi fosfat 0.1M , $\text{pH} = 7.0$, vëllimi i injektimit $100 \mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

6.1.3 Efekti i vlerës pH

Ndikimi i pH është studiuar në vlera nga 6 deri në 8. Ky interval është përdorur ngase këtu kemi efektin më të madh katalitik të enzimës. Rezultatet kanë treguar që efekti më i lartë katalitik është arritur në $\text{pH} 7.0$, që është në korrelacion me studimet paraprake [117, 118].

6.1.4 Përformanca e sistemit

Përformanca e sistemit të propozuar është studiuar në potencialin operues optimal. Limiti i detektimit (LOD) dhe ai i kuantifikimit (LOQ) janë llogaritur sipas ekuacionit $LOD = 3 s/k$ dhe $LOQ = 10s/k$, respektivisht, s paraqet devijimin standard për pesë përsëritje ($n = 5$) në përqendrimet të paracetamolit $5 \mu\text{M}$ dhe k paraqet pjerrtësinë e drejtëzës kalibruese. Një amperogram tipin i fituar në sistemin (FIA) është paraqitur në Fig. 4.8, ku është aplikuar potenciali operues -0.15 V . Rendi linear në përqendrime nga $4.0 - 130 \mu\text{mol L}^{-1}$ është paraqitur si më i miri në këto kushte, kufi të detektimit $LOD = 1.1 \mu\text{mol L}^{-1}$, tek potenciali operues 0 V , $3.0 - 90 \mu\text{mol L}^{-1}$ me $LOD = 0.8 \mu\text{mol L}^{-1}$ në potencial operues -0.1 V , dhe $1.5 - 70 \mu\text{mol L}^{-1}$ me $LOD = 0.5 \mu\text{mol L}^{-1}$ në potencial operues -0.15 V .




Figura 4.8 Sinjali amperometrik gjatë shtimit të paracetamolit në përqendrimet të ndryshme, në potencial operues 0 V . Elektroliti mbështetës puferi fosfat 0.1 , $\text{pH} = 7.0$, vëllimi i injektimit $100 \mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C .

Ekuacioni i parë i përshkruar ka vlerat $I_p = -0.0083c + 0.0101$ me koeficient të korrelacionit $r = 0.9987$ është përdorur për ta përcaktuar APAP në mostrat model, dy llojet e tabletave dhe në urinën e njeriut (Fig. 4.9).




Figura 4.9 Sinjali amperometrik gjatë shtimit të paracetamolit në përqendrime të ndryshme, në potencial operues -0.15 V. Elektroliti mbështetës pufër fosfat 0.1 mol ·L⁻¹, pH = 7.0, vëllimi i injektimit 100 µL, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min⁻¹ dhe temperatura: 25°C.

Në krahasim me biosensorët tjerë të zhvilluar (Tabela 4.2), duhet theksuar se progres thelbësor në ndjeshmëri është arritur në potencialin operues - 0.15 V.

Tabela 4.2. Prezantimi dhe krahasimi i disa biosensorëve elektrokimik për përcaktimin e paracetamolit.

| Lloji i sensorit | Material i biologjik | Limiti i detektimit (LOD) (μM) | Rendi linear (μM) | R^2 | Referenca |
|---|----------------------|---|--------------------------------|--------|-----------|
| CPE/avokado-PPO | Fruta dhe perime | ----- | 120–5800 | 0.9927 | [17] |
| CPE/patëllgjanin e zi-PPO | | 5 | 20-200 | ---- | [18] |
| CPE/bananë-PPO/hidrogjel | | 1.6 | 10–250 | 0.995 | [19] |
| CPE/juruba-PPO | | 3 | 5-245 | 0.9994 | [20] |
| CPE/kungulleshë-PPO | | 69 | 120-2500 | 0.9965 | [21] |
| SPCE/aril-acilamidazë | Enzima | -- | 0–2800 | 0.999 | [22] |
| ACeO ₂ @GNR/IJPCNT | | 0.18 | 1-100 | 0.9987 | [23] |
| CPE/TiO ₂ /LAC | | 1 | 8-120 | 0.997 | [24] |
| GC/MWCNT/LAC | | 7 | 10-320 | 0.994 | [25] |
| Au/PANI-cMWCNT/Bacillus sp./GA | Bakterie | 2.9 | 5-630 | 0.995 | [26] |
| SPE-CoPC/tyrosinase | Enzimë | 0.5 | 1.6-40 | --- | [27] |
| Elektroda e diamantit e dopuar me bor(BDDE) | /// | 7.1 | 20-400 | 0.999 | [28] |
| Au/cistinë/ADN | Acid nukleik | 7.8 | 65-730 | 0.997 | [29] |

CPE – Elektroda pastë karboni, PPO-Polifenol oksidazë, MWCNT – Nanotuba të karbonit shumë shtresor, SPCE- electrode e prontuar nga e karbonit, PANI – Polianilina, CoPC – Kobalt ftalocianinë, SPE – electrode e printuar, ACe-amidazë cerium, O₂@GNR – dioksid grafeni, IJPCNT- nanotuba të printuar, LAC-lakaza, GC-karboni qelqor.

Biosensorët ekzistues të bazuar në enzima të ndryshme nuk sigurojnë një përzgjedhje të tillë për t'u përdorur në analizën e urinës njerëzore. Biosensorët enzimatikë të raportuar më parë janë përdorur në përcaktimin e APAP vetëm në formulimet farmaceutike [119-120].

Tabela 4.3. Stabilizimi i sinjalit tek biosensori i ri.

| Sensori | Koha [min] | Sensitiviteti relativ [%] | RSD [%] |
|-----------|---------------|---------------------------|---------|
| Biosensor | 0(sensori ri) | 100 | 9.64 |
| Biosensor | 15 | 90.65 | 6.78 |
| Biosensor | 28 | 68.94 | 6.45 |
| Biosensor | 38 | 66.26 | 1.93 |
| Biosensor | 45 | 66.53 | 2.01 |
| Biosensor | 50 | 66.43 | 1.95 |

Biosensori i sapo përgatitur ka treguar sjellje të paqëndrueshme për shkak të enzimës, e cila nuk është inkorporuar plotësisht në sipërfaqen e elektrodës. Pas gjysmë ore janë fituar pike konstante të rrymë elektrike me devijim standard relativ (RSD) më pak se 2% pasi që është bërë shpëlarja e enzimës së pa inkorporuar (Tabela 4.3). Pas kësaj kohe nuk është vërejtur zbritje e ndjeshme e sinjalit amperometrik.




Figura 4.10. Procesi i stabilizimit të elektrodës gjatë largimit të enzimës së pa inkorporuar.

Në Figurën 4.10 mund të vërehet qartë stabiliteti e sinjalit, ndërsa riprodhueshmëria ka qenë e mjaftë e mirë me vlera të RSD = 1.9%.




Figura 4.11 Amperogram i fituar në sistemin FIA si rezultat i injektimit të tretësirës së paracetamolit me përqendrim të ndryshme në potencial -0.15 V. Elektroliti mbështetës puferi fosfat $0.1 \text{ mol} \cdot \text{L}^{-1}$, $\text{pH} = 7.0$, vëllimi i injektimit $100 \text{ } \mu\text{L}$, shpejtësia e rrjedhjes: 0.6 mL min^{-1} dhe temperatura: 25°C

Një parametër tjetër i rëndësishëm është koha e përgjigjes që zakonisht në celulën thjeshtë elektrokimike është me shpejtë se sa në sistemin FIA. Koha e përgjigjes varet nga distanca e injektorit nga celula elektrokimike dhe shpejtësia e rrjedhjes. Duke i ditur këta dy faktor mund të llogaritet edhe ky parametër që në këtë rast ka qenë më pak se 5 s.

Karakteristike për biosensorët nga tirozinaza është jetëgjatësia e shkurt e tyre [69, 121]. Prandaj, një studim bazë për jetëgjatësinë e biosensorit është realizuar për të gjetur nëse biosensori i zhvilluar mund të përdoret në analizat rutinë farmaceutike dhe klinike. Në përgjithësi, mund të thuhet se një biosensor i sapo përgatitur mund të përdoret për analiza gjatë një dite të tërë. Problemi kryesor mbetet ruajtja e biosensorit. Kjo çon në një rënie të ndjeshme të ndjeshmërisë. Stabiliteti i sistemit është vlerësuar duke injektuar çdo ditë $50 \text{ } \mu\text{mol L}^{-1}$ APAP ($n = 5$). Gjatë 6 ditëve të para, sinjali amperometrik i produktit enzimatik është ulur ndjeshëm, duke vazhduar edhe me tej të ulet dhe më në fund në ditën e 12 -të është bërë i qëndrueshëm (Fig. 4.12). Duhet të jetë e qartë se ndjeshmëria zvogëlohet ndjeshëm me “plakjen” e biosensorit. Nga pikëpamja praktike, nuk ka asnjë problem për të përdorur një elektrodë tashmë të përgatitur, dhe para çdo analize të vendoset enzimë e freskët e tirozinazës. Për më tepër, duhet të përmendet se

komercialisht janë të disponueshme elektrodën e printuara me grafen që e bënë me të lehtë përgatitjen e biosensorit dhe për më tepër e zbeh problemin e jetëgjatësisë së tij.




Figura 4.12 Jetëgjatësia e biosensorit

Në përmbajtjet e tabletave farmaceutike zakonisht kemi niseshte misri, PVP, natriumi kroskarmelozë dhe acid stearik. Këto komponime nuk mund të klasifikohen si pengesa gjatë matjeve sepse nuk i nënshtrohen asnjë reaksioni elektrokimik në potencialet e aplikuara të punës. Kështu, janë zhvilluar metoda të shumta të drejtpërdrejta voltametrike për përcaktimin e APAP në formulimet farmaceutike [122-124]. Në rastin e urinës situata është pak më e komplikuar, por për faktin se biosensori është o aftë të punojë në potencialin 0 V ku mundësi e reduktimit ose oksidimit të një substance tjetër është shumë e vogël ka bërë që dhe këtu interferencat mos të paraqesin pengesë. Kjo edhe mund të argumentohet ngase vlera e sinjalit amperometrik në rastin e testimit të urinës së pastër ka qenë më e ulët se devijimi standard ($n = 5$) i APAP me përqendrim $50 \mu\text{mol L}^{-1}$ si shtesë në mostrën e urinës.

6.1.5 Analiza e tabletave farmaceutike dhe urinës

Para analizës së mostrave reale, ka qenë e nevojshme të përcaktohej saktësia e sistemit të propozuar. Saktësia paraqet përputhjen midis përqendrimit real të analitit dhe atij të gjetur nga një metodë analitike e përdorur. Ky parametër analitik shpesh verifikohet duke përdorur analizën e një mostre modeli (“recovery”), sasinë e deklaruar, ose duke e krahasuar me një metodë referimi të bazuar në një parim tjetër fiziko - kimik. Të dyja qasjet e përmendura janë përdorur për vërtetimin e saktësisë. Një rikuperim me vlera prej 3.8% të RSD është arritur të fitohet nga pesë përsëritje për FIA të një mostre model, që përmbante $250 \mu\text{mol L}^{-1}$ APAP. Para analizës, mostra e model duhej të holllohej dhjetëfish duke përdorur PB. Edhe pse kjo punë

i kushtohet analizës së urinës njerëzore, ishte e udhës që së pari të testohet biosensori në analizën e preparateve farmaceutike, veçanërisht të tabletave.




Figura 4.13. Kromatogrami i fituar gjatë analizës së mostrës së urinës së pastër me HPLC (vija e plotë) dhe urinës që përmban $50 \mu\text{mol L}^{-1}$ paracetamol (vija e ndërpresë). Është përdorur kolona Ascentis Express C18 (150 mm x 3.0 mm, $2.7 \mu\text{m}$). Gjatësia valore e detektimit ka qenë 243 nm. Ndarja është realizuar duke përdorur fazën mobile e përbërë nga 0.3% acid formik në ujë (A) dhe metanol (B) me program të gradientit nga 20% deri në 40% B për 10 min në temperaturë konstante 30°C . Shpejtësia e rrjedhjes ka qenë 0.5 mL min^{-1} , vëllimi i injektimit $5 \mu\text{L}$.

Një protokoll i përshkruar më parë për analizën e urinës duke përdorur HPLC është modifikuar pak duke ndryshuar parametrat e eluimit me gradient për të parandaluar shpëlarjen e substancave shoqëruese që ekzistojnë në matricën e mostrës në të njëjtën kohë me analitin (Fig. 4.14). Tretësirat standarde ($3.0\text{--}50 \text{ mg L}^{-1}$) për kalibrim janë përgatitur duke e holluar APAP në metanol. Drejtëza kalibruese është përshkruar me këtë ekuacion: $A [\text{mAU}] = 17,610.82 + 35,118.84c [\text{mg L}^{-1}]$ me korrelacion $r = 0.9993$. Siç shihet në tabelën 6.4 biosensori i zhvilluar ka rezultate të krahasueshme me metodat referente të zgjedhura me vlera të “recovery” 97.4% ($n = 5$).

Tabela 4.4 Krahasimi i rezultateve të FIA-s me ato të HPLC për mostrat farmaceutike dhe atë të urinës

| Mostra | FIA | HPLC | Deklaruar |
|---|-----------------------------------|------------------------------------|----------------------------|
| Model | $242 \pm 19 \mu\text{mol L}^{-1}$ | $244 \pm 9 \mu\text{mol L}^{-1}$ | $250 \mu\text{mol L}^{-1}$ |
| Paralen® 500 | $490 \pm \text{mg}$ për tabletë | $491 \pm 16 \text{mg}$ për tabletë | 500 mg për tabletë |
| Tylox® 750 | $725 \pm \text{mg}$ për tabletë | $745 \pm \text{mg}$ për tabletë | 750 mg për tabletë |
| Urinë ($50 \mu\text{mol L}^{-1}$ APAP) | $52 \pm 4 \mu\text{mol L}^{-1}$ | $51 \pm 3 \mu\text{mol L}^{-1}$ | $50 \mu\text{mol L}^{-1}$ |

Të gjitha analizat e përzgjedhura janë përsëritura 5 herë dhe rezultatet finale janë prezantuar në intervale të besueshmërisë $\bar{x} \pm st1-\alpha$, ku \bar{x} është mesatarja aritmetike, s devijimi standard dhe $t1-\alpha$ vlerat kritike të shpërndarjes së Studentit t (2.015) për numrin e dhënë të përcaktimeve në shkallë të besueshmërisë α prej 0.05 (95% të probabilitetit).

4.2. Karakterizimi elektrokimik dhe performanca analitike e biosensorit elektrokimik bazuar në elektrodën e pastër karboni për përcaktimin e polifenoleve

Në mënyrë që të bëhet analiza e frutave për përmbajtjen e polifenoleve dhe duke u mbështetur edhe në artikujt paraprak [125, 126], është dashur të bëhen dhe disa optimizime të kushteve të punës siç është shpejtësia e përzierjes, potenciali operues, vlera pH e elektrolitit mbështetës në etj. Për më tepër disa karakteristika tjera lidhur me elektrodën janë shtuar. Nga studimi paraprak [126] është vërtetuar se elektroda pastër karboni e modifikuar me nanotuba shumë shtresor tregon të ketë sensitivitet më të lartë se elektroda e pastër për shkak se elektroda e modifikuar ka sipërfaqe specifike më të lartë, elektronet transferohen më shpejtë. Gjithashtu përzierja e enzimës me nafion ka treguar stabilitet të lartë në sipërfaqen CNTs për shkak të strukturës fibroze të polimerit duke depërtuar në tufën e nanotubave të karbonit. Karakteristika e sipërfaqes së elektrodës së modifikuar me nanotuba të karbonit dhe atë të pa modifikuar është analizuar duke përdorur SEM (Fig. 4.14).




Figura 4.14 Fotografitë e fituara nga SEM për elektrodën e pastër (A) dhe elektrodën e modifikuar me nanotuba të karbonit (B)

4.2.1 Konstruktimi i biosensorit

Efektet katalitik të tirozinazës kundrejt Troloksit në krahasim me 1,2-dihidroksibenzenet është shumë më i ulët dhe për këtë arsye nuk mund të ndërtohet biosensor i thjeshtë [59]. Kjo tregon që sasia e produktit të oksiduar të Troloksit në sipërfaqen e elektrodës për është i vogël, dhe për ta konstruktuar një biosensor të tillë duhet një sipërfaqe specifike më e madhe në mënyrë që të rritet sinjali analitik. Kjo mund të arrihet duke përdorur nanomaterialë të karbonit siç janë nanotubat e karbonit shumë shtresor të cilat jo vetëm që e rritin sipërfaqen aktive por edhe transferimi i elektroneve është më i shpejtë.

Gjashtë përqendrime të ndryshme (0.5, 1.0, 1.5, 2.0, 2.5, dhe 3.0 mg mL⁻¹) të MWCNT në DMF janë përgatitur dhe vëllimi prej 20 µL është aplikuar për imobilizimin e MWCNT në sipërfaqen e CPEs. Elektrodën CPE/MWCNT janë krahasuar më pas duke përdorur voltmetri ciklike ku përqendrimi Troloksit ka qenë 500 mol L⁻¹. Siç tregohet në Figurën 6.15, në përqendrimin 2 mg mL⁻¹ kemi sinjalin maksimal dhe ky përqendrim është përzgjedhur i optimi për matjet e tjera.




Figura 4.15 Efekti i sasisë së natotubave të karbonit të disperguara në DMF në piket e rrymave anodike (E_p^a) dhe atyre katodike (E_p^c) në përqendrimin e Troloksit 5×10^{-4} mol L⁻¹ tek elektroda pastë karboni, elektroliti mbështetës puferi fosfat 0.1 mol L⁻¹ (pH 7.0), shpejtësia e skanimit 0.05 V s⁻¹.

Më pas vëllime prej 5, 10, 15, 20, 25, dhe 30 μ L me përqendrim konstant 2.0 mg mL⁻¹ të MWCNTs janë aplikuar në sipërfaqen e elektrodës pastë karboni për ta gjetur sasinë optimale të nanotubave të karbonit në aspektin vëllimor. Rezultatet kanë treguar në vëllimet nga 15-25 μ L ka pasur rritje të dukshme në rrymat katodike. Vëllimet më të mëdha se 25 μ L me gjasë e kanë bllokuar sipërfaqen e elektrodës duke mos dhënë sinjale më të mirë. Vëllimi prej 20 μ L është përzgjedhur si optimali. Edhe sasia e enzimës në këtë rast është optimizuar. Duke e rritur sasinë e saj është vërejtur rritje të rrymat katodike dhe ngritje tek rrymat anodike kundrejt Troloksit. Sasi më e lart e enzimës se 3.0 μ g nuk ka treguar ndonjë ngritje të dukshme të sinjalit analitik dhe si e tillë është përzgjedhur si optimale.

4.2.3 Karakteristikat e biosensorit

Sjellja elektrokimike e Troloksit është hulumtuar në tri llojet e elektrodave; atë CPE, CPE/MWCNTs, dhe CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® për ta gjetur efektin e secilës komponent. Troloksi ka prodhuar reaksion tipik reversibil ($\Delta E_p = 65$ mV) në elektrodën e pastër, duke iu atribuar oksidimit një elektronik në një kation radikal e duke transferuar një proton më vonë për të formuar një fenoksi radikal dhe menjëherë duke u oksiduar në feniksi kation, njëjtë sikurse tek α -tokoferolet [70]. Pas përsëritjeve të cikleve në voltametri, është vërejtur edhe një çift redoks ($\Delta E_p = 280$ mV). Mund të thuhet se pas formimit të kationit fenoksonium, një adicione nukleofilik i ujit fillon duke shoqëruar formimin e Troloks kinoneve përmes hemiketalve intermediate. Troloks kinonet me pas reduktohen në hidroktoni përkatëse, e që

mund të oksidohen në kinone në skanimin pas në potenciale pozitive [57, 70]. Rritja e sinjalit për qiftin redoks sekondar për secilin cikël është shkaktuar nga grumbullimi gradual i Troloks kinoneve nga oksidimi i substancës origjinale (Fig. 4.16A).




Figura 4.16 Voltamogramet ciklike ($n = 10$) të përsërituar në përqendrimet e Troloksit $500 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ të fituara në elektrodën e pastër (A) dhe voltamogramet ciklike për Troloksin me përqendrim $500 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ në elektrodën e pa modifikuar CPE (vija e zezë), CPE/MWCNTs (vija e kaltërt) dhe CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® (vija e kuqe) (B), në pufurin fosfat $0.1 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, $\text{pH} = 7.0$, $E_{\text{fillstare}} = 0 \text{ V}$, $E_{\text{vertex1}} = -0.5 \text{ V}$, $E_{\text{vertex2}} = +1.3 \text{ V}$, $E_{\text{step}} = 5 \text{ mV}$, $v = 10 \text{ mV}\cdot\text{s}^{-1}$.

Raporti i intensitetit të rrymave elektrike ($I_{\text{pa}}/I_{\text{pc}}$) ka qenë i barabartë me 1.544 tek elektroda e pamodifikuar, ndërsa 0.615 dhe 0.320 tek CPE/MWCNTs respektivisht CPE/MWCNTs/TYR/Nafion®. Shumë herë më i lartë është shfaqur piku reduktues në rastin e përdorimit të CPE/MWCNTs/TYR/Nafion®, në potencialin (E_{pc}) $+0.049 \text{ V}$ (krahasuar me vlerat $+0.079$ dhe $+0.099 \text{ V}$ për CPE/MWCNTs dhe CPE respektivisht), ku piku i oksidimit është zbritur për shkak të efektit katalitik të enzimës (Fig. 4.16B) kundrejt Troloksit. Duke ju referuar këtyre gjetjeve, potenciali operues me vlera më të ulëta se $+0.050 \text{ V}$ duket të hulumtohet për përcaktimet amperometrike. Gjithashtu bazuar në të dhënat eksperimentale të fituara, principi i këtij biosensori amperometrik për përcaktimin e sasive totale antioksiduese është realizuar, që mundëson përcaktimin elektrokimik të Troloksit në potenciale të ulëta me sensitivitet të shtuar.

6.2.4 Aktiviteti i tirozinazës kundrejt Troloksit

Më herët me anë të voltametrisë ciklike është parë që tirozinaza mund të katalizojë oksidimin e Troloksit në kinone përkatëse. Por kjo duhej të konfirmohej me eksperimente shtesë. Troloksi ka absorbancë maksimale në 291 nm (vija e kuqe në Fig. 4.17). Në prani të tirozinazës një tjetër mbi mbulim me absorbancë maksimale në gjatësi valore 278 nm paraqitet. Gjerësia e shiritit absorbues të ri rritet me kohën e pranisë së enzimës, siç tregohet në Fig. 4.18. Ky fenomen mund të konsiderohet si informacion shtesë që Troloksi nuk e inhibon efektin katalitik të enzimës por paraqet një substrat. Sidoqoftë, një reaksion polimerik i Troloksit i katalizuar nga enzima nuk mund të përjashtohet.




Figura 4.17 Spektri ultraviolet i tirozinazës me përqendrim $50 \mu\text{g}\cdot\text{mL}^{-1}$ (lakorja e zezë) dhe $100 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ duke përdorur puferin fosfat $0.1 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH = 7.0 për 0 (lakorja e kuqe), 10 (lakorja kaltër), 20 (lakorja e gjelbër), dhe 30 min (lakorja e verdh).

4.2.4 Efekti i shpejtësisë së përzierjes dhe vlerës pH

Në përcaktimet amperometrike shpejtësia e përzierjes paraqet një faktor të rëndësishëm që mundëson rrugëtimin e analitëve deri tek sipërfaqja e elektrodës në mënyrë sa më efikase duke mundësuar që gjatë gjithë kohës së analizës sipërfaqja e elektrodës të furnizohet me molekula të analitit ose analitëve. Për të hulumtuar këtë parametër janë përzgjedhur shpejtësitë e përzierjes nga 100 deri në 500 rpm. Deri në shpejtësinë 400 rpm sinjali është ngritur dukshëm, shpejtësi më të larta se 400 rpm nuk kanë pasur ndonjë efekt të theksuar dhe për këtë arsye shpejtësia e përzierjes 400 rpm është zgjedhur si më e mira.

Tirozinaza ka efekte katalitike të dobëta në mjedis acidike dhe bazike ndërsa efekte maksimale në vlera neutrale efekte maksimale [127,128]. Matjet eksperimentale edhe kanë dëshmuar këtë duke dhënë sinjal analitik maksimal në pH = 7.0.

4.2.5 Efekti i potencialit operues

Nëse detektimi elektrokimik i produktit nga reaksioni enzimatik ndodhë në vlera konstante të potencialit, atëherë madhësia e potencialit luan rolin kryesor në përcaktimin amperometrik. Varësia e lartësisë së rrymës reduktuese ndaj potencialit operues mund të shihet në Fig. 4.18. Potenciali operues -0.25 V ka gjeneruar sinjal më të lartë dhe për këtë arsye është përzgjedhur e që korrespondon me të dhënat paraprake në përcaktimin e (reduktimin) p-kinoneve [125]. Për më tepër potencialet më të ulëta se -0.3 V kanë ndikuar që të kemi rrymë bazike jo stabile për shkak të ndikimit të oksigjenit.




Figura 4.18 Efekti i potencialit operues kur është përdorur CPE/MWCNTs (a), dhe CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® (b). Analiti $500 \mu\text{mol}\cdot\text{L}^{-1}$ Troloks; elektroliti mbështetës puferi fosfat $0.01 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH 7.0; shpejtësi e përzierjes 400 rpm.

4.2.6 Analiza e frutave

Përmbajtja e lagështisë është përcaktuar fillimisht, duke i thatë frutat në peshë konstante në temp. 60°C . Sasi më e lartë e ujit është vërejtur tek dredhëzat (93 %), kurse sasi më e ulët tek mjedrat (82%). Për frutat tjera të analizuara përmbajtja e ujit ka qenë 85%. Sasi totale antioksiduese është përcaktuar në 100 g të frutave të thara, dhe për këtë arsye ka qenë e rëndësishme të dihet sasia e ujit për ta përcaktuar më pas sasinë totale antioksiduese në indet e njoma (frutat e pa thara).

Për ta eliminuar matriksin e mostrës, është përdorur metoda me shtesa të standardit me anë të biosensorit të zhvilluar në kushte optimale të cilat janë përcaktuar paraprakisht. Vëllim prej 1.0 mL të ekstraktit të frutave është vendosur në 9 mL pufer fosfat dhe më pas janë shtuar 3 ose 4 shtesa të standardit nga 0.5 mL secila (Troloks $0.01 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$). Pas llogaritjes së rezultateve është fituar ekuacioni $I(\mu\text{A}) = -2.0082 c (\text{mmol}\cdot\text{L}^{-1}) - 1.5137 (\mu\text{A})$ dhe $R^2 = 0.9978$ siç tregohet në Fig. 4.19.




Figura 4.19 Analiza e TEAC duke përdorur metodën e shtimit të standardit me anë të biosensorit CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® në potencialin operues -0.25V , shpejtësi e përzierjes 400 rpm.

Metoda referente (DPPH) është përdorur me këto parametra të kalibrimit për substancën standarde Troloksin $A = -0.0103 c (\text{mmol} \cdot \text{L}^{-1}) + 0.3516$ dhe $R^2 = 0.9943$.

Koha e reagimit ka qenë e ndryshme për frutat e përzgjedhura. Është interesant të theksohet se kohë më e shkurt e reagimit është parë tej mjedrat ($< 10\text{ s}$) se sa tek Troloksi ($> 25\text{ s}$). Kjo për arsye se mjedrat përmbajnë komponime fenolike të cilat janë më të përshtatshme për tirozinazën (substrat më të përshtatshëm).

Në aspektin e jetëgjatësisë, biosensori është testuar për dy javë duke përdorur tretësirën e Troloksit me përqendrim $150\text{ } \mu\text{mol L}^{-1}$ për çdo dy ditë (Fig. 4.20). Sinjali i biosensorit qëndron stabile për një javë.




Figura 4.20 Amperogram tipik i fituar duke përdorur biosensorin elektrokimik CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® gjatë shtimit individual të Troloksit me përqendrim $150 \mu\text{mol L}^{-1}$. Elektroliti mbështetës puferi fosfat $0.01 \text{ mol}\cdot\text{L}^{-1}$, pH 7.0; shpejtësi e përzierjes 400 rpm.

Vlerat finale për analizën e TEAC për secilën frutë me anë të biosensorit elektrokimik dhe asaj referente (DPPH) janë paraqitur në Tabelën 4.5.

Tabela 4.5 Përmbajtja e TEAC dhe AA në fruta të ndryshme

| Frutat | AA në Pulp ^b [mg për 100 g] | | Acidi askorbik në pulp ^b [mg/100 g] |
|-----------------|---|--------------------------|--|
| | Biosensori ^a | Metoda DPPH ^a | |
| Dredhëza | 1569 (133) | 6735 (570) | 59 |
| Manaferra | 2593 (337) | 3868 (503) | 30 |
| Mjedra | 5317 (793) | 5968 (890) | 32 |
| Boronicë | 1917 (270) | 4878 (687) | 14 |
| Boronicë e kuqe | 6738 (935) | 8027 (1114) | 13 |

^aVlerat janë dhënë si mesatare aritmetike e pesë përsëritjeve. B Vlerat për përmbajtjen e AA janë marr nga U. S Department of Agriculture [129, 130-131].

Nga tabela mund të vërehet lehtë se vlerat nuk janë të njëjta nëse i krahasojmë dy metodat e përdorura.. Në përgjithësi, matjet me metodën DPPH ofrojnë riprodhueshmëri të mirë me 95 %. Riprodhueshmëria tek biosensori elektrokimik ka qenë e krahasueshme me metodën referente DPPH, për veç se në rastin e dredhëzave (90%). Kjo mund të shkaktohet nga përmbajtja e lartë e antioksidantëve jofenolike: AA, karrotenidet, mineralet me veti reduktuese, etj. dhe nga prezenca e fibrave të patretshëm. Për shembull, prania e AA në pulpë të dredhëzës është 90 mg 100 g⁻¹. Prezenca e AA në fruta është e njohur dhe vlerat mund të mirren nga National Nutrient Database (USDA) (U.S. Department of Agriculture, 2010); si referencë, e që janë paraqitur gjithashtu në Tabelën 6.5. Rezultatet e paraqitura janë kompaktibile edhe me referencat [130, 131].

Për më tepër, biosensori amperometrik CPE/MWCNTs/TYR/Nafion® mund të përdoret për përcaktimin e sasive totale fenolike (TPC) [132] dhe gjithashtu sasive totale antioksiduese (TAC) [133] ekuivalent me Troloksin për mostrat që kanë vlera të ulëta të antioksidantëve jofenolik. Për frutat e thara(boronicë, boronica e kuqe, mjedër), vlerat për TEAC të fituara nga biosensori elektrokimik janë në korrelacion të mirë me metodën referente DPPH si vërehet në Tabelën 6.5. Një diskrepancë e madhe mund të vërehet boronica, sidomos verat e fituar me rastin e analizimit të pulpës, vlera e TEAC janë shumë më të ulëta se matjet që janë realizuar me metodën referente. Kjo me gjasë prezencës së sasive të larta të anthoksianinës e cila e nxit aktivitetin anti-Tirozinazë [134].

Një tjetër karakteristik e cila duhet të përmendet është sasia e lartë e AA në dredhëza (sipas literaturës). Tirozinaza katalizon vetëm oksidimin e komponimeve fenolike dhe për këtë arsye sasi e vogël e TEAC është gjetur në këtë frutë me përdorimin e biosensorit amperometrik. AA ndikon që të zbritet intensiteti i ngjyrës së tretësirës alkoolike të DDPH, dhe që për pasojë ka rritjen e vlerave të sasive totale antioksiduese. Biosensori amperometrik i zhvilluar mund të aplikohet me sukses për përcaktimin e TPC dhe TEAC në mostrat në të cilat përmbajtja e polifenoleve janë dominant si komponentë antioksiduese. Krahasimi me metoda referente tjera siç janë ORAC, FRAP DHE TRAP janë paraqitur në Tabelën 4.6.

Tabela 4.6. Shqyrtimi i vlerave të TEAC në pulp të frutave përcaktuar nga analizat tjera TEAC (mg për 100 g)

| Frutat | TEAC (mg për 100 g) | | |
|-----------------|---------------------|-------------------|-------------------|
| | ORAC ^a | FRAP ^b | TRAP ^c |
| Dredhëza | 1077 | 543 | 214 |
| Manaferra | 1478 | 1269 | 526 |
| Mjedra | 1268 | 994 | 262 |
| Boronicë | 1169 | 911 | 233 |
| Boronicë e kuqe | 2275 | 1259 | 678 |

Të dhënat për TEAC janë marr nga referencat ^a[53,55] dhe ^c[137].

Vlerat korresponduese të TEAC në fruta marr nga analizat individuale janë gjetur ose llogaritur duke u mbështetur në literaturën përkatëse [8,135–138].

Biosensori elektrokimik ka ofruar sensitivitet të ngjashëm ndaj metodave DPPH dhe TRAP. Në krahasim me metodën ORAC, sensitiviteti i biosensorit është dy herë më i ulët. Nga të gjitha metodat analitike të përdorura mundësia më e ulët për ta larguar ndikimin negativ të radikaleve të lira është vërejtur tek dredhëzat dhe e kundërta tek boronica e kuqe. Nëse dëshirojmë të krahasojmë kapacitetin antioksidues për secilën frut, biosensori elektrokimik ofron informacione të ngjashëm si DPPH, ORAC dhe TRAP analizat në këtë sekuencë: boronicë e kuqe > mjedër > manaferra > boronicë > dredhëz. Koeficienti i korrelacionit $R^2 = 0.8409$ është gjetur gjatë krahasimit të biosensorit elektrokimik me metodën DPPH në analizën e TEAC në secilën pulp të frutave, Figura 4.21.

Për më tepër duket që ORAC dhe TRAP metodat japin sasi më të ulëta të TEAC vlerave se sa biosensori elektrokimik i zhvilluar dhe dy metodat tjera spektrometrike. Një sqarim për këtë mund të gjendet në format e ndryshme të polifenoleve që gjenden në mjedër dhe boronicë të kuqe, që me siguri përmbajnë sasi më të larta të polifenoleve të pasura me grupe ketolike në strukturën e vet kimike.




Figura 4.21. Krahasimi i biosensorit elektrokimik me metodat tjera analitike (A) DPPH, (B) ORAC, (C) FRAP, (D) TRAP për analizën e TEAC në pulp të dredhëzës (Dre), manaferrave (Man), mjedrës (Mjed), boronicës (Bor) dhe boronicës së kuqe (Bkuqe).

4.3 Përcaktimi i kapacitetit total antioksidues ekuivalent me troloksin në mostrat e çokollatës duke përdorur elektrodën e diamantit dopuar me bor në sistemin ma analizë ne rrjedhje

4.3.1. Voltametria ciklike

Duke përdorur voltametrinë ciklike është bërë e mundur të studiohet sjellja elektrokimike e 13 substancave të ndryshme të cilat janë potencialisht të pranishme në kakao si antioksidantë. Matjet janë realizuar duke përdorur pufer fosfat 0.1 M, pH =7.0 dhe gjithashtu pufer i njëjtë fosfat por me përqindje të metanolit në rastet kur substancat nuk kanë pasur tretshmëri në pufer të pastër.

Me anë të voltametrisë ciklike lehtë mund të vërehen piket e oksidimit për secilën substancë të analizuar dhe kjo është një ndihmës e madhe për ta përcaktuar potencialin operues në ampermetrinë hidrodinamike. Piket e observuara të oksidimit të këtyre substancave janë: acidi kafeik në +0.398 V, kamferoli në +0.483 V, acidi klorogjenik në +0.505 V, acidi sinapik +0.620 V, acidi gallik në +0.635 V, (+)-katehina në +0.640 V, L-acidi arkorvik në +0.649 V, vanilina (VA) në +0.688 V, (-)-epikatehina në +0.744 V, naringina në +1.011 V, acidi kanellik në +1.133 V, kafeina në +1.384 V, dhe theobromina në +1.404 V.

Në figurën 4.22 janë paraqitur voltamogramet ciklike të troloksit, vanilinës dhe theobrominës. Tek troloksi mund të vërehet se oksidohet në potencialin +0.623 V. Fukusi vendoset tek Troloksi ngase kjo substancë përdoret si standard për përcaktimin e sasive totale të antioksidantëve dhe gjitha kalibrimet janë bërë duke përdorur troloksin si standard. Por sidoqoftë ky potencial operues nuk është i favorshëm për një pjesë të madhe substancash të cilat oksidohen në potenciale më pozitive (deri në +1.4V), kështu që potenciali operues duhet të bëjë të mundur oksidimin e të gjitha substancave, në mënyrë që të bëhet përcaktimi total I antioksidantëve në mostrën e analizuar.

Voltametria ciklike jep të kuptojmë gjithashtu që molekulat e oksiduara të cilat mbesin aftër elektrodës e bllokojnë në një formë sinjalin ngase nuk lejojnë që molekulat tjera të pa oksiduara të arrijnë në sipërfaqen e elektrodës. Kjo pasi që pas një numri të shkurtë të cikleve intensiteti i rrymës bie për arsytet e përmendura më lartë. Ky problem do të eliminohet duket përdorur sistemin me injektim në rrjedhje.

